



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. 44/2023 regjistër (JR)
Datë 05.10.2023

Nr. 85 i vendimit
Datë 19.11.2025

VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Mimoza Tasi	Relatore
Rezarta Schuetz	Anëtare
Natasha Mulaj	Anëtare
Sokol Çomo	Anëtar

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, më datë 19.11.2025, ditën e mërkurë, ora 10:00, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësor Inva Hasho, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Bardhyl Shehu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 694, datë 10.08.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.

BAZA LIGJORE: Neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut; nenet 33, 42, 179/b, pikat 2 dhe 5 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet A, Ç, D, Dh, E dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë; nenet 59/1, 62, 63, pika 1, nenet 65 dhe 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; nenet 46, 50 dhe 51 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar; neni 465 e vijues i Kodit të Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore, në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit dhe parashtrimet e subjektit të rivlerësimit, dëgjoji gjyqtaren relatore të çështjes, Mimoza Tasi, si dhe, pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Bardhyl Shehu (në vijim “subjekti i rivlerësimit”), për shkak të ushtrimit të funksionit të prokurorit pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë, në zbatim të nenit 179/b, pika 3 e Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, dhe nenit 3, pika 16 e ligjit nr. 84/2016, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*.
2. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”) ka zhvilluar hetime vetëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë. Në zbatim të përcaktimeve të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni ka administruar raportin e vlerësimit të hartuar nga Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), sipas të cilit, në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, ka konstatuar për subjektin e rivlerësimit Bardhyl Shehu se: (i) *deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin*; (ii) *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar burimin financiar të krijimit të pasurive*; (iii) *ka mosdeklarim të pasurisë ndër vite dhe transaksion të dyshimtë, blerje/shitje pasurie të paluajtshme*; (iv) *nuk ka kryer deklarim të rremë*; (v) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

II. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

3. Komisioni, me vendimin nr. 694, datë 10.08.2023, ka vendosur: “*Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, z. Bardhyl Shehu, prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë*” [...].
4. Ky vendim është marrë nga Komisioni bazuar në përcaktimet e nenit 61, pikat 3 dhe 5, të ligjit nr. 84/2016, në vijim të konkluzioneve të mëposhtme, lidhur vetëm me kriterin e vlerësimit të pasurisë, për të cilin ka konkluduar se:
 - 4.1. Subjekti i rivlerësimit nuk ka shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive të tij, në referim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë.
 - 4.2. Subjekti i rivlerësimit ka ndërmarrë hapa për të fshehur/paraqitur në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim apo përdorim të tij, në referim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.
 - 4.3. Bazuar në paragrafin 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pamjaftueshëm për kriterin e kontrollit të pasurisë.

4.4. Bazuar në paragrafin 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te drejtësia.

III. Shkaqet e ankimit

5. Kundër vendimit të Komisionit ka ushtruar ankim, në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”), subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “b” e ligjit nr. 84/2016, duke kërkuar nga Kolegji: (i) ndryshimin e vendimit të Komisionit dhe konfirmimin në detyrë ose (ii) prishjen e vendimit dhe urdhërimin e Komisionit të vazhdojë të kryejë procesin e rivlerësimit edhe për dy kriteret e tjera, atë të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale.
6. **Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:**

6.1. Lidhur me shkaqet e ankimit me natyrë procedurale dhe procesin e rregullt ligjor, subjekti i rivlerësimit pretendon se:

(i) Komisioni i ka cenuar të drejtën për t’u dëgjuar drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të caktuar, pasi megjithëse ka paraqitur raport mjekësor për mosprezencën e tij në seancën dëgjimore të datës 07.08.2023, Komisioni nuk e ka marrë parasysh këtë fakt, duke vazhduar seancën dëgjimore në mungesë, ndërkohë që ai ishte i sëmurë, duke i mohuar të drejtën për t’u mbrojtur vetë dhe/ose të drejtën për t’u mbrojtur me avokat.

(ii) Komisioni nuk ka marrë në konsideratë kërkesat e tij më datë 08.08.2023, për shtyrjen e seancës dëgjimore për shkak të gjendjes së tij shëndetësore dhe për riçeljen e hetimit administrativ për dy kriteret e tjera, duke krijuar një marrëdhënie të tillë që ngre dyshime serioze për njëanshmërinë e trupit gjykues.

(iii) Komisioni ka cenuar parimin e kontradiktoritetit, parimin e barazisë së armëve, pasi i janë vënë në dispozicion rezultatet e hetimit, por jo provat e mbledhura gjatë procesit të tij të rivlerësimit, duke i mohuar të drejtën e aksesit te provat, si dhe pretendon se vendimi i Komisionit ka qenë i paragjykuar, pasi jo vetëm nuk i ka marrë për bazë shpjegimet e rezultateve të hetimit dhe provat e paraqitura prej tij, por edhe nuk i ka studiuar ato.

(iv) Komisioni nuk mund ta mbështeste vendimin e tij të shkarkimit në pikën 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi ky kriter kërkon që subjekti të ketë cenuar secilin prej kriterëve në një masë të atillë, sa të jetë cenuar besimi i publikut te sistemi i drejtësisë, në një kohë që ai nuk është hetuar për kriterin e kontrollit të figurës dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale.

(v) Komisioni ka shkelur nenin 18 të Kushtetutës, si dhe nenin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat garantojnë barazinë e trajtimit të subjekteve, për sa kohë gjenden në kushte të njëjta, çka, në rastin e tij, nuk ka ndodhur, pasi Komisioni ka refuzuar kërkesat e tij për shtyrje të seancës dëgjimore dhe riçelje hetimi, ndërsa subjekteve të tjera ua ka dhënë këtë mundësi.

6.2. Shkaqet e ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

6.2/a. Lidhur me pasuritë “apartament me sipërfaqe 138 m²” dhe “garazh me sipërfaqe 18.6 m²”, të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit kundërshton si të gabuar konkluzionin e

Komisionit për ligjshmërinë e burimeve që kanë shërbyer për blerjen e tij, pasi Komisioni nuk e ka konsideruar si burim shumën prej 180.000 eurosh, që i ka dhënë babai dhe vëllezërit, në këmbim të një objekti me sipërfaqe 16 m² dhe tokës përreth, rreth 180 m², ndodhur në vendin e quajtur “{***}”, Tiranë.

6.2/b. Lidhur me aftësinë financiare të vëllezërve të tij, subjekti i rivlerësimit pretendon se tre nga vëllezërit e tij, për shumë vite, kanë punuar në shtetin grek, ku dy prej tyre kanë punuar përreth 14 vjet. Sipas subjektit, pjesën më të madhe të likuiditetit e ka dhënë vëllai i tij L., pasi ka pasur likuiditet më tepër nga të tjerët, meqenëse u largua në Amerikë dhe, në vitin 2010, është pajisur me numër pune. Subjekti pretendon se ka paraqitur në ILDKPKI dhe janë administruar në dosje, edhe dokumente justifikuese për aftësinë paguese të njërit prej vëllezërve, L. Sh., i cili ka emigruar në SHBA, si: kopje të llogarisë bankare, numër pune dhe numër biznesi.

6.2/c. Lidhur me pasurinë “automjet”, tip “Mercedes-Benz”, me targë {***}, blerë në shumën **2.000 euro**, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit, *se ai ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar blerjen e saj, referuar vlerës reale të paguar prej tij*, është i gabuar, pasi shuma e parave për blerjen e automjetit është paguar nga kunati, A. T., i cili ka pasur të ardhura nga biznesi i tij. Subjekti pretendon se në kontratën e shitblerjes së automjetit është vënë një çmim i tillë, për shkak se me shitësin P. D., kunati i tij ka pasur marrëdhënie pune/biznesi, dhe aq ishte detyrimi që ka pasur ndaj tij. Subjekti pretendon se nuk ka pasur asnjë marrëdhënie pune dhe as marrëdhënie tjetër të çfarëdoshme me shitësin e kësaj makine.

6.2/ç. Lidhur me pasurinë “truall me sip. 1.058 m²”, të ndodhur në bulevardin “{***}”, me çmim **45.094.790 lekë**, subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit, *se ai nuk ka arritur të provojë të kundërtën e barrës së provës, edhe lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie dhe mosdeklarimin e tyre në deklaratën vetting*, është i gabuar dhe i pabazuar në fakte, pasi bashkëshortja e tij e ka nënshkruar kontratën për blerjen e truallit në mirëbesim, si “përfaqësuese” e vëllait të saj, për shkak se ky i fundit, ato ditë nuk kishte mundësi të vinte në Tiranë, dhe se palët shitëse, gjithsej 8 (tetë) persona, nuk mund të ishin të disponueshëm ditë tjetër për t’u paraqitur te noteri. Subjekti pretendon se bashkëshortja e tij nuk ka dhënë asnjë lekë nga shuma që figuron në kontratën e shitblerjes për blerjen e truallit, dhe nuk ka asnjë dijeni se në çfarë mënyre u janë dhënë lekët shitësve të truallit, ndërkohë që vëllai i bashkëshortes është biznesmen, për të cilin ka sjellë dokumentacion që ushtron aktivitetin në tregtimin e hidrokarbureve.

6.2/d. Sa i përket burimit të të ardhurave lidhur me këto transaksione, subjekti pretendon se familja e tij nuk është përfshirë fare në dhënien apo marrjen e lekëve, respektivisht nga blerja dhe shitja e pronës, pasi me këtë është/duhet të jetë marrë vëllai i bashkëshortes, madje, në mbështetje të këtij argumenti, ai ka dorëzuar vërtetimin, datë 29.06.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Dhoma Civile), sipas të cilit, vëllai i bashkëshortes së tij, A. T., është në proces gjyqësor për pasurinë e lartpërmendur, me shoqërinë “{***}” ShPK.

6.2/dh. Në lidhje me depozitën në Intesa Sanpaolo Bank, në shumën **3.465.600 lekë**, subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit, *se ai ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj depozite*, si të pabazuar në prova dhe ligj, pasi, për krijimin e kësaj depozite, një pjesë e saj dhe konkretisht shuma prej 3.000.000 lekësh, është dhuruar nga vëllai i

bashkëshortes, A. T. Sipas subjektit, kjo shumë është kaluar nga llogaria e kunatit të tij në llogarinë e bashkëshortes në Emporiki Bank, si garanci për në ambasadë, për të nxjerrë një vizë greke, për kurimin e djalit të tyre në Greqi dhe, më pas, vëllai i bashkëshortes nuk ia ka kërkuar shumën në fjalë, pra ia ka dhuruar këtë shumë.

Në lidhje me mundësinë financiare të kunatit, subjekti pretendon se ai e ka pasur dhe e ka aftësinë financiare për dhënie likuiditetesh, pasi ai ka biznese në Tiranë dhe në rrethe të tjera, ka qenë një nga aksionarët në kompaninë e naftës, që operonte në zonën Vlorë – Fier.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi aspektet procedurale të gjykimit

a) Juridiksioni i Kolegjit

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, dhe nenin F, pikat 1 dhe 2, të Aneksit të Kushtetutës, si e vetmja gjykatë e procesit të rivlerësimit, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) për shqyrtimin e ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin e subjekteve, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4 të Kushtetutës, përveç rasteve të vendimeve të dhëna sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka për objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka vendosur për rivlerësimin e subjektit Bardhyl Shehu, duke e shkarkuar atë nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

b) Legjitimimi i ankuesit

8. Ankuesi legjitimohet (*ratione personae*), në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, dhe (*ratione temporis*), pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh¹ nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2, të ligjit nr. 84/2016.

c) Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

9. Në përputhje me nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankimohet nga subjekti i rivlerësimit, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi, përveç rasteve kur plotësohen kriteret e përcaktuara në nenin 51 të ligjit nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 49/2012”, i ndryshuar), për shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore, me praninë e palëve. Për rrjedhojë, edhe çështja objekt gjykimi, e cila lidhej me shqyrtimin e vendimit nr.

¹ Siç rezultoi nga aktet e administruara në fashikullin gjyqësor, vendimi i Komisionit nr. 694, datë 10.08.2023, për rivlerësimin e subjektit Bardhyl Shehu, i është njoftuar subjektit të rivlerësimit më datë 15.09.2023, ndërsa ankimi i subjektit rezultoi të jetë depozituar në Komision në datën 26.09.2023, konfirmuar sipas të dhënave të vulës së protokollit të Komisionit, nr. {***}, datë 26.09.2023, që rezultoi të jetë dita e 11-të nga data e marrjes dijeni për vendimin e Komisionit, sipas njoftimit të këtij të fundit. Komisioni, me vendimin nr. 694/1, datë 26.09.2023, ka vendosur të pranojë ankimin e datës 26.09.2023, si ankim të plotë dhe në përputhje me nenin 46 të ligjit nr. 49/2012, “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

694, datë 10.08.2023, të Komisionit, bazuar në shkaqet e ngritura në ankimin e subjektit të rivlerësimit, u mor fillimisht në shqyrtim nga Kolegji në dhomë këshillimi.

10. Trupi gjykues i Kolegjit (në vijim “trupi gjykues”) konstaton se subjekti i rivlerësimit, në ankimin e paraqitur në Kolegj, më datë 26.09.2023, por edhe në parashtrimet e dorëzuara në Kolegj përpara seancës gjyqësore, në datën 13.11.2025, nuk ka paraqitur akte të reja, por vetëm më datë 14.11.2025, subjekti i rivlerësimit depozitoi në protokollin e Kolegjit dokumentin “Parashtrime shtesë”, së bashku me disa akte² bashkëlidhur.
11. Lidhur me provueshmërinë e këtyre akteve në këtë fazë të gjykimit në Kolegj, në zbatim të parashikimeve të nenit 65, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, procesi gjyqësor në Kolegj zhvillohet sipas një grupi dispozitash të ligjit nr. 49/2012, përfshirë nenet 47, 49 dhe 51 të këtij ligji. Sipas parashikimeve të nenit 47 të ligjit nr. 49/2012 dhe nenit 49 të ligjit nr. 84/2016, për sa u përket provave, vlerësimi i tyre dhe i akteve të administruara gjatë procesit të zhvilluar në Komision është pjesë e qenësishme e procedurës së analizimit të shkaqeve të ankimit nga Kolegji.
12. Nga analizimi i akteve bashkëlidhur parashtrimeve shtesë konstatohet se ato nuk pasqyrojnë të dhëna të prodhuara për herë të parë pas dhënies së vendimit të Komisionit dhe se ato përmbajnë të dhëna të viteve më parë, të cilat subjekti kishte mundësi t’i paraqiste gjatë hetimit administrativ, pra nuk mund të argumentohet që paraqitja e tyre në Komision ka qenë e pamundur. Madje, kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.08.2010, me palë bashkëshorten e subjektit, E. Sh., dhe L. M., ndodhet e administruar në dosjen e Komisionit. Lidhur me tri raportet mjekësore për paaftësi në punë, nxjerrë nga sistemi *e-albania*, të lëshuara nga Qendra Shëndetësore nr. {***} Tiranë, në datat 18.07.2023, 24.07.2023 dhe 07.08.2023, trupi gjykues konstaton se raporti për paaftësi të përkohshme në punë, i datës 18.07.2023, është depozituar në Komision dhe, madje për këtë arsye, Komisioni ka pranuar kërkesën e subjektit, duke vendosur shtyrjen e seancës dëgjimore të parashikuar për t’u zhvilluar më datë 19.07.2023. Ndërsa, lidhur me raportet mjekësore të datave 24.07.2023 dhe 07.08.2023, subjekti kishte mundësinë që t’i paraqiste ato konform ligjit në Komision, por edhe së bashku me ankimin e depozituar në Kolegj.
13. Për rrjedhojë, trupi gjykues i përjashtoi aktet e depozituara me parashtrimet shtesë nga analiza e mëtejshme në drejtim të vlerës së tyre provuese në zgjidhjen e çështjes, pasi vlerësoi se nuk plotësojnë kërkesat e nenit 49, pika 2 e ligjit nr. 49/2012, sipas të cilave, deri pesë ditë përpara seancës së shqyrtimit të çështjes, palët kanë të drejtë të paraqesin parashtrime me shkrim vetëm lidhur me shkaqet e ngritura në ankim, por jo prova të reja.

² Tri raporte mjekësore për paaftësi në punë, nxjerrë nga sistemi *e-albania*, të lëshuara nga qendra shëndetësore, datë 18.07.2023, 24.07.2023 dhe 07.08.2023; kontrata e shitblerjes me kusht, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 15.09.2017, me palë vëllain e bashkëshortes së subjektit të rivlerësimit, A. T., dhe L. M.; kontrata e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 21.08.2010, me palë bashkëshorten e subjektit, E. Sh., dhe L. M.; deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 09.09.2017, lëshuar nga përfaqësuesi ligjor i shoqërisë “{***}” ShPK, si dhe formulari i transfertës bankare për përmbushjen e detyrimit të kontratës së shitjes me kusht të vitit 2017.

14. Pavarësisht nga ky vlerësim ligjor, trupi gjykues vëren se aktet e sjella me parashtrimet shitesë, për të provuar aspekte të ndryshme të pretendimeve të subjektit, nuk kapërcejnë as kriteret e përcaktuara në nenin 49, pika 6, gjerat “a”, “b” dhe “d”, të ligjit nr. 84/2016, pasi marrja e tyre duket e panevojshme apo se pretendojnë të provojnë fakte që, edhe nëse pranohen të vërteta, nuk ndikojnë në vendimmarrjen përfundimtare.

B. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit lidhur me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor dhe aspektet procedurale të procesit të rivlerësimit

15. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni i ka cenuar të drejtën për t’u dëgjuar drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të caktuar, pasi megjithëse ka paraqitur raport mjekësor për mosprezencën e tij në seancën dëgjimore të datës 07.08.2023, Komisioni nuk e ka marrë parasysh këtë fakt, duke vazhduar seancën dëgjimore në mungesë, ndërkohë që ai ishte i sëmurë, duke i mohuar të drejtën për t’u mbrojtur vetë dhe/ose të drejtën për t’u mbrojtur me avokat.

16. Në kuadër të shqyrtimit të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues analizoi dokumentacionin e ndodhur në dosjen e Komisionit, si dhe procedurën e ndjekur prej tij, nga ku rezulton se:

16.1. Komisioni, fillimisht me vendimin nr. 4, datë 18.07.2023, ka vendosur të ftojë subjektin e rivlerësimit Bardhyl Shehu për t’u dëgjuar në seancë dëgjimore më datë 19.07.2023, ora 13:00.

Në datën 18.07.2023, për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore, subjekti kërkoi shtyrjen e seancës dëgjimore që ishte planifikuar në datën 19.07.2023. Bashkëlidhur kërkesës, subjekti i rivlerësimit dërgoi rekomandimin³ e mjekes së familjes A. Q., si dhe raportin për paaftësi të përkohshme në punë, lëshuar nga Qendra Shëndetësore nr. {***}, me numër regjistri {***}, raport i nënshkruar elektronikisht dhe i gjeneruar nga sistemi *e-albania*.

16.2. Komisioni, pasi analizoi dokumentacionin e depozituar, vlerësoi se ai plotësonte kriteret ligjore të vlefshmërisë, sipas rregullores nr. 2666/1, datë 21.06.2022, *“Për kriteret, rregullat dhe procedurat e lëshimit të raporteve mjekësore elektronike për paaftësitë e përkohshme për punë, për barrë lindje dhe për aksidente në punë e sëmundje profesionale”*, dhe njoftoi subjektin se, pasi është njohur me dokumentacionin e dërguar, raportin për paaftësi të përkohshme, pas njoftimit të datës dhe orës së zhvillimit të seancës, pranoi kërkesën për shtyrjen e seancës dëgjimore, nga data 19.07.2023, ora 13:00, për në datën 07.08.2023, ora 13:00.

16.3. Komisioni njoftoi subjektin se ka vlerësuar shtyrjen e zhvillimit të seancës me këtë afat kohor, duke e orientuar, në mënyrë që, nëse gjendja e pamundësisë shëndetësore do të vijonte, ai të kishte mundësi të merrte masa dhe të ushtronte të drejtën e marrjes së një përfaqësuesi ligjor, me qëllim njohjen e tij me dosjen e rivlerësimit, si dhe me shpjegimet e paraqitura pranë Komisionit në përgjigje të barrës së provës, për të bërë të mundur prezencën apo përfaqësimin me mbrojtës ligjor në seancën e datës 07.08.2023, ora 13:00.

³ Kjo mjeke, në rekomandim e saj, e ka përshkruar gjendjen shëndetësore si: *“Pacienti ankohet për çrregullim të ekuilibrit dhe të vjella”*, duke rekomanduar rikontrollin e pacientit në datën 20.07.2023.

16.4. Në datën 07.08.2023, para zhvillimit të seancës dëgjimore, nëpërmjet komunikimit elektronik, subjekti i rivlerësimit i kërkoi Komisionit të shtyjë seancën dëgjimore për muajin tjetër, pasi gjendja shëndetësore e tij, referuar diagnozës dhe sipas mjekut specialist, kërkonte kohë që të stabilizohej. Subjekti sqaroi se, për shkak të problemeve me sistemin, ende nuk i ishte dërguar raporti mjekësor dhe se, sapo t'i dërgohej, do t'ia përcillte edhe Komisionit. Më datë 07.08.2023 është protokolluar në sekretarinë e Komisionit, kërkesë nr. {***} prot., në të cilën subjekti i rivlerësimit kërkon shtyrjen e seancës dëgjimore të datës 07.08.2023, për shkak të gjendjes së tij shëndetësore të pastabilizuar, duke i bërë me dije Komisionit se është pajisur me raport mjekësor nga data 07.08.2023 – 17.08.2023, duke i bashkëlidhur kësaj kërkesë një dokument “fotografi të ekranit të një kompjuteri”, për të cilin pretendoi se ishte raporti mjekësor.

16.5. Komisioni, me vendimin nr. 5, datë 07.08.2023, ka vendosur mospranimin e kërkesës për shtyrje të seancës dëgjimore për arsye se dokumentacioni i dorëzuar nga subjekti, si nëpërmjet komunikimit elektronik dhe në protokollin e Komisionit, në datën 07.08.2023, nuk plotësonte kriteret ligjore të vlefshmërisë, sipas nenit 14 të rregullores nr. 2666/1, datë 21.06.2022, “*Për kriteret, rregullat dhe procedurat e lëshimit të raporteve mjekësore elektronike për paaftësitë e përkohshme për punë, për barrëlidhje dhe për aksidente në punë e sëmundje profesionale*”, pasi në fotokopjen e dorëzuar nuk rezultoi të kishte numër regjistri dhe nuk ishte i nënshkruar elektronikisht, sipas kërkesave ligjore, duke vendosur vijimin e seancës dëgjimore të parashikuar për t’u mbajtur më datë 07.08.2023, ora 13:00. Në seancën dëgjimore të datës 07.08.2023, e cila u zhvillua pa praninë e subjektit të rivlerësimit, në prani të vëzhguesit ndërkombëtar W. B., në përfundim të shpjegimit të përmbajtjes së dosjes së rivlerësimit nga relatorja, trupi gjykues i Komisionit u tërhoq për vendim, të cilin e shpalli më datë 10.08.2023.

Komisioni vlerësoi se subjekti, deri në orën e zhvillimit të seancës dëgjimore, nuk arriti të provojë me asnjë dokument ligjor me vlerë provuese, gjendjen e tij shëndetësore apo edhe kërkimin e bërë ndaj Komisionit lidhur me shtyrjen e seancës.

16.6. Lidhur me këtë shkak ankimi, sikurse konstatohet nga analiza e fakteve të pasqyruara më lart, konkretisht dhënia e kohës së mjaftueshme në dispozicion për paraqitjen e shpjegimeve, shtyrja e zhvillimit të seancës dëgjimore, dëshmojnë qartë se Komisioni ka respektuar gjendjen shëndetësore të subjektit të rivlerësimit dhe pasojën që ajo ka dhënë në zhvillimin e procesit, edhe pse i kishte sjellë në vëmendje, në mënyrë konstante, mundësinë për t’u përfaqësuar nëpërmjet një përfaqësuesi ligjor. Për këtë arsye, Komisioni, duke mbajtur në konsideratë sjelljen e subjektit, me paraqitjen e raporteve mjekësore, pikërisht në ditën kur ishin caktuar seancat dëgjimore në Komision, i ka vlerësuar ato si përpjekje të tij për të shtyrë jo vetëm seancën dëgjimore, por edhe si përpjekje për shtyrjen dhe vonesën e procesit e tij të rivlerësimit, pasi, me veprimet dhe mosveprimet e tij, është përpjekur të ndikojë në pengimin e punës së organeve të rivlerësimit, duke përmbushur në këtë mënyrë kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

17. Trupi gjykues konstaton se dokumenti “foto”, i pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si raport mjekësor, dorëzuar prej tij ditën që ishte caktuar seanca dëgjimore e datës 07.08.2023, megjithëse është fotokopje, i mungojnë elementet e vlefshmërisë së tij, sikurse është siglimi i mjekut apo numri i regjistrisë, madje,

nga një krahasim me raportin mjekësor të sjellë nga vetë subjekti disa ditë më parë, më datë 19.07.2023, dallohen qartë diferencat midis tyre.

Trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit se, për shkaqe të mosfunksionimit të sistemit, e ka pasur të pamundur të paraqiste raportin mjekësor, sipas formës së kërkuar nga ligji, pasi nga aktet nuk rezulton që ai të ketë bërë ndonjë përpjekje për të vërtetuar këtë fakt, madje nuk ka as edhe ndonjë konfirmim që sistemi nuk ka funksionuar pikërisht atë ditë. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk është kujdesur që të merrte ndonjë akt provues/vërtetim nga qendra shëndetësore apo mjeku i familjes për pamundësinë e shkarkimit nga sistemi të raportit mjekësor për paaftësinë në punë. Në rast se subjekti i rivlerësimit do të ndodhej në pamundësi për ta dorëzuar raportin mjekësor në formën e kërkuar nga ligji në datën e seancës dëgjimore, ai mund ta paraqiste atë në seancën e shpalljes së vendimit ose, fare mirë, mund t’ia bashkëlidhte ankimit kundër vendimit të Komisionit të paraqitur në Kolegj, për t’u vlerësuar më pas nga ky i fundit.

17.1. Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të mos i paraqesë Komisionit të gjithë situatën e tij mjekësore, kështu ai nuk i ka bërë me dije Komisionit raportin mjekësor për paaftësi të përkohshme në punë për periudhën 24.07.2023 – 03.08.2023, por vetëm me parashtimet shpesh të depozituara në Kolegj, më datë 14.11.2025, e ka bashkëlidhur këtë raport mjekësor.

17.2. Lidhur me pretendimin e subjektit se, si pasojë e mosprezencës të tij në seancën dëgjimore të datës 07.08.2023, i është mohuar e drejta për t’u mbrojtur, trupi gjykues konstaton se Komisioni e ka pranuar kërkesën e subjektit për shtyrjen e seancës dëgjimore, të planifikuar për t’u zhvilluar më datë 19.07.2023, duke e shtyrë atë në datën 07.08.2023, pra, e ka shtyrë atë me rreth 19 ditë kalendarike. Madje, Komisioni, në njoftimin që i ka bërë subjektit, i ka sugjeruar atij që të merrte masa dhe të ushtronte të drejtën e marrjes së një përfaqësuesi ligjor, i cili do të mundësonte prapësimet e tij në seancën e radhës, nëse gjendja e pamundësisë shëndetësore do të vijonte. Sikurse rezulton, duket se ka qenë një zgjedhje personale e subjektit për të mos e ushtruar të drejtën për të marrë një përfaqësues ligjor, në përputhje me nenet 35 dhe 38 të Kodit të Procedurave Administrative, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se i është mohuar e drejta e mbrojtjes me avokat, është i pabazuar.

17.3. Një rrethanë tjetër, që dëshmon se subjektit nuk i është mohuar e drejta e mbrojtjes, është edhe fakti se shpjegimet e dhëna prej tij me prapësimet, pas kalimit të barrës së provës në Komision, janë të njëjta me pretendimet e ngritura në ankimin e paraqitur në Kolegj, çka tregon se subjekti nuk duket të ketë pasur argumente/shpjegime apo prova shpesh që mund t’i paraqiste ndryshe në seancën dëgjimore dhe, për rrjedhojë, të jetë pamundësuar për të ushtruar të drejtën e mbrojtjes.

17.4. Sa i përket *email*-it të datës 08.08.2023, ora 14:18, drejtuar Kryetarit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, z. R. I., nëpërmjet të cilit subjekti i rivlerësimit pretendon se refuzimi i kërkesës për shtyrje të seancës dëgjimore të datës 07.08.2023 është në shkelje të hapur të ligjit, trupi gjykues konstaton se relatorja e kësaj çështjeje, nëpërmjet *email*-it të datës 08.08.2023, ora 14:50, ka njoftuar Kryetarin e Komisionit se ky trup gjykues ka përfunduar “deliberation” (bisedimet) për çështjen e këtij subjekti në mbledhjen e së njëjtës ditë, në orën 10:00 – 11:00. Pra, kërkesat e subjektit ishin paraqitur në një fazë procedurale, kur trupi gjykues i Komisionit ishte tërhequr për marrjen e vendimit përfundimtar dhe çdo komunikim me palët kishte përfunduar, duke përmbyllur fazën e vendimmarrjes mbi aktet që ishin

administruar. Për rrjedhojë, në respektim të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, kërkimet dhe dokumentacioni i depozituar nga subjekti në këtë fazë të hetimit ishin objekt i punës administrative të Komisionit, pasi në këtë fazë procedurale, trupi gjykues kishte marrë vendimin për zgjidhjen përfundimtare të çështjes.

17.5. Nga sa më lart, trupi gjykues, në analizë të veprimeve të subjektit të rivlerësimit, vëren se paraqitja e një raporti mjekësor jo në formën e kërkuar nga ligji (vetëm një fotografi), pikërisht ditën e zhvillimit të seancës dëgjimore, më datë 07.08.2023, apo mosbërja me dije e Komisionit për raportin tjetër mjekësor, të datës 24.07.2023, si dhe faktit se, pavarësisht se subjekti pretendonte se ishte pajisur me raport për paaftësi të përkohshme në punë, ai ka vijuar komunikimin me Komisionin, jo me trupin gjykues që po shqyrtonte procesin e tij të rivlerësimit, por me Kryetarin e Komisionit, duke i drejtuar atij kërkesa që nuk ishin në kompetencë të tij, tregojnë për një tendencë të qëllimshme të subjektit të rivlerësimit për anashkalimin e trupit gjykues dhe shtyrjen e seancave dëgjimore të caktuara nga Komisioni, pikërisht në fazën e fundit të procesit të rivlerësimit, pra në momentin që subjekti duhej të përballej me konkluzionet e Komisionit në seancën dëgjimore. Për rrjedhojë, pretendimet e subjektit të rivlerësimit, për cenimin e të drejtës për t'u dëgjuar apo për t'u mbrojtur, janë të pabazuara në prova dhe ligj.

18. Në shqyrtim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit, *se Komisioni ka cenuar të drejtën për një proces të rregullt ligjor, duke ngritur dyshime serioze për njëanshmërinë e tij, pasi ka refuzuar kërkesën e tij, megjithëse ai ka kërkuar të kryhet rivlerësimi edhe për dy kritere të tjera (kriterin e kontrollit të figurës dhe kriterin e vlerësimit profesional)*, trupi gjykues, pas verifikimit të akteve në fashikujt e Komisionit, konstaton se, me vendimin nr. 3, të datës 18.07.2023, Komisioni ka vendosur mospranimin e kërkesës së subjektit për çeljen e hetimit edhe për dy kriteret e tjera, atë të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit profesional. Me email-in e datës 18.07.2023, Komisioni e ka njoftuar subjektin për refuzimin e kërkesës së tij deri në atë fazë të hetimit administrativ, por duke i shpjeguar se, pas zhvillimit të seancës dëgjimore, do të vlerësojë nëse ka vend për të çelur hetimin administrativ për dy kriteret e tjera.

18.1. Trupi gjykues sjell në vëmendje faktin se, në parashikimet e nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, përcaktohet qartë se vendimi nga institucionet e rivlerësimit merret duke u bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve ose në vlerësimin tërësor të procedurave. Ky interpretim shihet në lidhje të ngushtë dhe në harmoni me përcaktimet e nenit 59 të ligjit nr. 84/2016, i cili, në pikën 1, parashikon se konfirmimi në detyrë i jepet subjektit të rivlerësimit në rast se plotësohen së bashku kushtet për arritjen e një niveli të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, kontrollit të figurës, dhe nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale. Ky parashikim i interpretuar *a contrario* lejon përfundimin e procesit të rivlerësimit, edhe mbështetur vetëm në një ose dy kritere, për ato raste kur për Komisionin rezulton se, nga hetimet e kryera për këto kritere, subjekti nuk arrin një nivel të besueshëm dhe konfirmimi në detyrë nuk është më një opsion i vlefshëm. Fakti që Komisioni nuk ka kundërshtuar qëndrimin e marrë në përfundim të hetimit administrativ, në raport me hetimin për dy kriteret e tjera, nuk mund të konsiderohet se ka munguar të vlerësojë kërkesën e subjektit për riçelje të hetimit për to, por se ka arritur në një konkluzion që e bënte të panevojshëm hetimin e mëtejshëm të çështjes, e cila mund të zgjidhej edhe vetëm mbi kriterin e vlerësimit të pasurisë. Gjithashtu, në

jurisprudencën⁴ e tij, Kolegji ka analizuar gjerësisht këtë pretendim, duke e konsideruar atë të pabazuar ligjërisht, arsyetim i cili vlen edhe në rastin objekt shqyrtimi.

19. Lidhur me pretendimin e subjektit, *se Komisioni ka cenuar parimet e kontradiktoritetit dhe të barazisë së armëve, pasi i janë vënë në dispozicion rezultatet e hetimit, por jo provat e mbledhura gjatë procesit të tij të rivlerësimit, duke i mohuar të drejtën e aksesit te provat, si dhe vendimi i Komisionit ka qenë i paragjykuar, pasi jo vetëm nuk i ka marrë për bazë shpjegimet e rezultateve të hetimit dhe provat e paraqitura prej tij, por edhe nuk i ka studiuar ato, pasi ai i ka dërguar shpjegimet më datë 17.07.2023, ora 20:00, të nesërmen, më datë 18.07.2023, është caktuar seanca dëgjimore më datë 19.07.2023, trupi gjykues konstaton si vijon:*

19.1. Komisioni, me vendimin nr. 2, datë 04.07.2023, ka vendosur të përfundojë hetimin administrativ dhe të njoftojë subjektin për t'u njohur me provat e administruara, në përputhje me nenin 47 të ligjit nr. 84/2016, neneve 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative. Në aktet e dosjes ndodhet një deklaratë, datë 07.07.2023, e subjektit të rivlerësimit Bardhyl Shehu, i cili deklaron se është njohur me dokumentacionin fizik dhe në formë elektronike (CD) të hetimit administrativ të kryer, dhe se nuk ka asnjë vërejtje në lidhje me dokumentacionin e tërhequr pranë Komisionit.

19.2. Komisioni, në kuptim e zbatim të nenit 87 të Kodit të Procedurave Administrative, ka realizuar detyrimin e tij si organ administrativ, duke garantuar të drejtën e subjektit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni dhe rezultatet e hetimit, si dhe për të paraqitur prova dhe argumente lidhur me gjetjet e rezultuara nga procesi i hetimit administrativ. Subjekti është njoftuar nëpërmjet komunikimit të rezultateve paraprake të hetimit për çdo çështje apo gjetje të rezultuar nga hetimi, për të cilat ai duhet të jepte shpjegime apo të sillte prova, duke i kaluar formalisht barra e provës, në kuptim e zbatim të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016. Fakti që Komisioni ka bërë një vlerësim të ndryshëm të tyre nga ai i pretenduar prej subjektit, nuk e shndërron hetimin në të paplotë, por përkundrazi, demonstroi një tagër diskrecionar të organeve të rivlerësimit, për të vlerësuar brenda logjikës dhe bindjes së tyre provat e paraqitura, në harmoni dhe krahasuar me të gjitha të dhënat e tjera që dalin nga hetimi. Në këto kushte, këtë pretendim të subjektit, trupi gjykues e konsideron si të pabazuar dhe jo të drejtë.

20. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk mund ta mbështeste vendimin e tij të shkarkimit në pikën 5, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, pasi ky kriter kërkon që subjekti të ketë cenuar secilin prej kriterëve, në një masë të atillë, sa të jetë cenuar besimi i publikut te sistemi i drejtësisë, në një kohë që ai nuk është hetuar për kriterin e kontrollit të figurës dhe kriterin e vlerësimit të aftësive profesionale. Sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duhet të plotësoheshin dy kushte në mënyrë kumulative, në mënyrë që Komisioni të dispononte me vendim shkarkimi.

20.1. Në përgjigje të këtij shkaku ankimi, trupi gjykues konstaton se Komisioni, pasi ka analizuar qëndrimin e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit të tij të rivlerësimit, ka vlerësuar se ai ndodhet në kushtet e cenimit të besimit të publikut te drejtësia, pasi me veprimet dhe mosveprimet e tij është përpjekur të ndikojë në pengimin e punës së organeve të rivlerësimit, duke përmbushur në këtë mënyrë kushtet e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.

⁴ Shih vendimet e Kolegjit nr. 15/2019 (JR), nr. 34/2019 (JR), nr. 23/2022 (JR) dhe nr. 28/2019 (JR).

20.2. Në analizë të këtij pretendimi, neni 179/b, pika 1 parashikon se rivlerësimi ka për qëllim të garantojë funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut te drejtësia. Sa i përket termit “besim i publikut”, megjithëse ligji nuk i ka dhënë një përkufizim, ai gjen vend në nenin 1 të ligjit nr. 84/2016, që përcakton qëllimin e këtij procesi, dhe nenin 61, pika 5 të tij, i cili parashikon shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit në rastin kur nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e ligjit, rezulton se subjekti ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit. Ky nen të orienton në përcaktimet e nenit 4, pika 2 e këtij ligji, sipas të cilit vendimi në kuadër të këtij procesi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të të tria kriterëve ose në vlerësimin tërësor të procedurave. Në këto kushte, parashikimi në nenin 48 të ligjit, se në marrjen e vendimit Komisioni dhe Kolegji mbajnë parasysh gatishmërinë dhe sjelljen e subjektit të rivlerësimit gjatë procesit, nuk mund të përjashtohet nga analizimi në kuadër të cenimit të besimit të publikut. Bashkëpunimi me Komisionin, në kuptim të këtij neni, bën pjesë në vlerësimin tërësor të procedurave dhe sjellja e subjektit gjatë këtij procesi vlerësohet në vendimmarrje.

20.3. Për sa më lart, dhënia e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, është rrjedhojë direkte e parashikimeve ligjore. Kolegji tashmë ka një jurisprudencë të konsoliduar në qëndrimin e shprehur për dhënien e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, bazuar në parashikimet e nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016⁵. Për rrjedhojë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se pretendimi i subjektit të rivlerësimit, se duhet të plotësoheshin dy kushte në mënyrë kumulative, në mënyrë që Komisioni të dispononte me vendim shkarkimi, është i pabazuar.

21. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, *se Komisioni ka shkelur nenin 18 të Kushtetutës, si dhe nenin 14 të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut, të cilat garantojnë barazinë e trajtimit të subjekteve për sa kohë gjenden në kushte të njëjta, pasi Komisioni ka refuzuar kërkesat e tij për shtyrje të seancës dëgjimore dhe riçelje hetimi, ndërsa subjekteve të tjera ia ka dhënë këtë mundësi*, trupi gjykues vlerëson se ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk mund të përbëjnë *a priori* shkak për të konsideruar të padrejtë vendimin objekt shqyrtimi. Çdo vendimmarrje e Komisionit vlerësohet nga Kolegji në mënyrë individuale, bazuar në specifikat e gjendjes faktike të provuar nga gjykimi dhe në zbatimin e duhur të ligjit për situatën konkrete faktike, dhe jo nga mënyra se si mund të jenë rivlerësuar subjektet e tjera të rivlerësimit nga Komisioni. Ky qëndrim i trupit gjykues mbështet nga jurisprudenca tashmë e konsoliduar e Kolegjit.
22. Trupi gjykues, pasi kontrolloi zhvillimin e procesit të rivlerësimit të subjektit në Komision, si dhe analizoi dokumentacionin e fashikujve të administruar gjatë hetimit në Komision, konstatoi se nuk rezulton asnjë qëndrim paragjykses i mbajtur nga Komisioni dhe as ndonjë pretendim i ngritur nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ në këtë drejtim. Proces i rivlerësimit është kryer sipas parashikimeve të akteve ligjore dhe rregullatore. Këto shkaqe ankimi janë ngritur nga subjekti i rivlerësimit vetëm pas njohjes me vendimin përfundimtar të Komisionit, për rrjedhojë, i bën këto pretendime të tij të pabazuara. Procedura e ndjekur nga ana e Komisionit, në trajtimin e kërkesave të

⁵ Shih vendimet nr. 34/2019, nr. 32/2019, nr. 28/2019, nr. 23/2019 dhe nr. 22/2019, të Kolegjit etj.

subjektit për marrjen e provave dhe vlerësimin e tyre, rezulton të jetë kryer në përputhje me parashikimet e nenit 49, pika 9 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, nuk u konstatuan shkelje të natyrës procedurale, të cilat mund të përbënin cenim të së drejtës së subjektit për proces të rregullt ligjor.

23. Në përfundim, trupi gjykues konstaton se nuk janë kryer shkelje procedurale, që të kërkojnë korrigjimin e tyre sipas parashikimeve të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar, duke e kaluar gjykimin e çështjes në seancë gjyqësore publike në prani të palëve. Për rrjedhojë, trupi gjykues vijoi me shqyrtimin e çështjes në dhomën e këshillimit, sipas parashikimeve të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, të ndryshuar.

C. Vlerësimi i shkaqeve të ankimit lidhur me kriterin e vlerësimit të pasurisë

24. Për pasuritë “apartament me sipërfaqe 138 m²”, blerë me çmim 151.440 euro dhe “garazh me sip. 18.6 m²”, blerë me çmim 30.000 euro, me çmim total në vlerën 181.000 euro, të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, Komisioni, duke mbajtur në konsideratë mungesën e provueshmërisë së burimeve të ligjshme për krijimin e shumës së pretenduar, prej 181.000 eurosh, konstatoi edhe faktin se subjekti dështoi të provojë ligjshmërinë e përfitimit të kësaj shume. Komisioni në vendim arriti në konkluzionin se subjekti nuk mundi të provojë burimet financiare të ligjshme të përdorura prej tij për krijimin e pasurive “apartament” dhe “garazh”, referuar standardit dhe kërkesave të nenit D, pikat 1 dhe 3 të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016, dhe ndodhet në kushtet e parashikimeve të germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

24.1. Subjekti i rivlerësimit, në ankimin e paraqitur në Kolegj, kundërshton konkluzionin e mësipërm të Komisionit si të gabuar, të arritur pa analizuar realisht provat dhe shpjegimet e tij, duke pretenduar se si burim krijimi për pasuritë “apartament” dhe “garazh” ka shërbyer shuma prej 181.000 eurosh, që i kanë dhënë babai dhe vëllezërit e tij, në këmbim të një objekti me sipërfaqe 16 m² dhe sipërfaqen e tokës përreth, rreth 180 m², ndodhur në {***}. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur të njëjtat argumente si në Komision pas dërgimit të rezultateve të hetimit administrativ, lidhur me historikun e përfitimit të kësaj toke dhe përfitimin e shumës, konkretisht si më poshtë:

(i) Subjekti ka sqaruar se në fillimet e demokracisë, rreth vitit 1993, babai i tij, Xh. Sh., dhe vëllezërit, A. Sh., D. Sh., H. Sh. dhe L. Sh., kanë blerë një sipërfaqe toke⁶ prej rreth 700 m², por pa përpiluar ndonjë akt noterial, në vendin e quajtur {***}, Tiranë. Në këtë parcelë toke, babai dhe vëllezërit e tij kanë ndërtuar një vilë trekatëshe, ndërsa jashtë kësaj ndërtese, por brenda kësaj sipërfaqeje toke, kanë ndërtuar një objekt 16 m², me idenë që në të ardhmen të ndërtohej një shtëpi më vete dhe pikërisht këtë objekt, me sipërfaqe 16 m² dhe sipërfaqen e tokës përreth, në total rreth 180 m², ata ia dhuruan subjektit pa ndonjë akt të shkruar, pasi nuk dispononin asnjë dokument pronësie mbi këtë tokë. Si për vilën 3-katëshe të babait dhe vëllezërve të tij, ashtu edhe për objektin me sipërfaqe 16 m² dhe parcelën e tokës përreth, është aplikuar për legalizim pranë ALUIZNI-t. Subjekti, gjatë hetimit administrativ në Komision, ka paraqitur në cilësinë e provës kopje të certifikatave dhe kartelat e pasurisë për pasurinë e lartpërmendur, regjistruar në emër të babait dhe vëllezërve të tij.

⁶ Sipas subjektit, këtë tokë babai i tij ia ka blerë, në shumën 20.000 lekë (të reja), një qytetari nga Burreli, i cili hiqej si pronar i tokës, ndërkohë që nuk dispononte asnjë dokument për këtë tokë.

(ii) Subjekti sqaron se në vitin 1998, pasi është martuar, ka banuar në një banesë me qira, të paguar nga familjarët e bashkëshortes së tij, ngjitur me banesën e tyre, në afërsi të Ministrisë së Jashtme, në Tiranë. Në kushtet kur prindërit e bashkëshortes ishin të sëmurë dhe kishin nevojë për ndihmë të vazhdueshme, ndërsa babai dhe vëllezërit e tij donin të hapnim një biznes privat në fushën e prodhim/shitje mobiliesh, kanë rënë dakord që të shkëmbenin pronën⁷. Kjo do t'i jepej babait dhe vëllezërve të tij dhe, në këmbim të kësaj pasurie, ata në vitin 2010 i kanë dhënë një shumë në total prej rreth 181.000 eurosh, për të blerë shtëpinë dhe një garazh në rrugën “{***}”, në Tiranë, shtëpi ku banon aktualisht.

(iii) Subjekti pretendon se, pavarësisht se kjo pronë figuron edhe sot *de facto* në posedimin e tij, nuk do të thotë se ai është pronar i kësaj prone, përderisa ajo nuk është e regjistruar në emrin e tij, pasi ai së bashku me vëllezërit dhe babain kanë nënshkruar një deklaratë noteriale në vitin 2016, ku ai ka hequr dorë nga kjo pronë dhe ajo do t'u kalojë atyre, pasi si vila, ashtu edhe objekti 16 m², nga fillimi deri në mbarim të tyre janë ndërtuar nga vetë vëllezërit dhe babai i tij. Sipas subjektit, nuk është përpiluar kontratë shitblerjeje prone, pasi prona nuk është e regjistruar dhe, sipas ligjit të noterisë, nuk mund të shesësh një pronë kur nuk je pronar.

(iv) Sa i përket vlerës që është konvertuar me sipërfaqen e tokës dhe objektin, subjekti pretendon se kjo është llogaritur duke marrë në konsideratë faktin se në atë sipërfaqe trualli do të ndërtohej një pallat, ashtu si janë bërë ndërtime pallatesh edhe në banesat e tjera, që e kanë hapësirën e nevojshme, siç është prona e vëllezërve të tij, t'i kthejnë në pallate.

(v) Lidhur me aftësinë financiare të vëllezërve të tij, subjekti sqaron se tre nga vëllezërit e tij, L. Sh., D. Sh. dhe A. Sh., për shumë vite, kanë punuar në shtetin grek, ku dy prej tyre, L. dhe D., kanë punuar për rreth 14 vjet⁸.

(vi) Sa i përket vendparkimit nr. {***}, për të cilin ka qenë nënshkruar kontrata nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.01.2011, për kalim të drejtash, në shumën 30.000 euro, subjekti pretendon se kjo kontratë është revokuar me mirëkuptim të të dyja palëve, sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep. dhe {***} kol., datë 22.04.2011 (është ndërruar garazhi nr. {***} me garazhin nr. {***}, që ka aktualisht) dhe palët nuk kanë pasur asnjë lloj pretendimi apo detyrimi ndaj njëri-tjetrit. Subjekti pretendon se ka pasur dhe ka në pronësi vetëm një garazh/vendparkim makine, i cili ndodhet në pallatin ku ai banon, që mban numrin {***}, vendparkimi me sip. 18.6 m².

24.2. Në funksion të analizimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues mori në shqyrtim dokumentacionin e ndodhur në fashikujt e Komisionit, si dhe deklaratimet e tij në deklaratën e pasurisë *vetting* (në vijim “deklarata *vetting*”), si dhe deklaratat e interesave pasurorë periodikë ndër vite (në vijim “DIPP”), ku rezultoi se:

⁷ Subjekti sqaron, sipas VKM-së nr. 677, datë 18.06.2009, është miratuar kalimi i pronësisë për sipërfaqen prej 144.5 m² dhe objektin me sipërfaqe 13.9 m² por nuk është kryer legalizimi, pasi sipas tij, sipërfaqja ishte shumë e vogël.

⁸ Sipas subjektit, pjesën më të madhe të likuiditetit e ka dhënë vëllai i tij, L., pasi ka pasur likuiditet më tepër nga të tjerët, sepse u largua në Amerikë dhe në vitin 2010 është pajisur me numër pune. Subjekti pretendon se ka paraqitur në ILDKPKI dhe janë administruar në dosje edhe dokumente justifikuese për aftësinë paguese të njërit prej vëllezërve, L. Sh., i cili ka emigruar në USA, si kopje të llogarisë bankare, nr. pune dhe biznesi.

24.2/a. Bashkëshortja e subjektit ka deklaruar në deklaratën vetting: “Apartament me sip. 138 m², nr. pasurisë {***}, vol. {***}, f. {***}, z. k. {***}, me adresë rr. “{***}”, pallati “{***}”, nr. {***}, Tiranë. Vlera: 151.440 euro.

Si burim krijimi për këtë pasuri ka deklaruar: “Në bazë të deklaratës noteriale nr. {***}, datë 22.06.2016, shuma e parave me të cilat kam blerë apartamentin është dhënë nga 4 vëllezërit e bashkëshortit tim, Bardhyl Shehu dhe prindërit e tyre (babai), në këmbim të pasurisë objekt me sip. 16 m² dhe sipërfaqe toke bashkë me këtë objekt, 180 m², që ndodhet në rr. “{***}”, aktualisht rr. “{***}”, tek {***}, Njësia Bashkiake nr. {***}, Tiranë (zonë informale në proces legalizimi, pasi do ta përdorin për interesin e tyre, për pallat a për biznes, meqenëse sipërfaqja e tokës që ato kanë, është e madhe, mbi 700 m²). Sa i përket aftësisë pagueuse, deklaroj se 2 nga vëllezërit e bashkëshortit kanë punuar prej rreth 14 vite në emigracion dhe për rreth 5 - 6 vite ka punuar dhe vëllai tjetër i tyre, A., e për pak kohë ka punuar edhe vëllai tjetër, H. Dokument tjetër justifikues për aftësinë pagueuse të njërit prej vëllezërve, L. Sh., i cili, në vitin 2010, ka emigruar në USA (kopje të llogarisë bankare, nr. punës, biznesit etj.)”. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës vetting dokumentet provuese⁹.

24.2/b. Në deklaratën para fillimit të detyrës në vitin 2013, dorëzuar më datë 09.01.2013, personi i lidhur me subjektin, bashkëshortja e tij ka deklaruar: “Apartament me sip. 151.44 m², në rr. {***}, pallati “{***}”, Tiranë. Vlera 151.440 euro. Pjesa takuese 100%. Burimi: 4 vëllezërit e bashkëshortit tim, me të cilët kemi rënë dakord t’u japim pronën tonë, e cila është brenda rrethimit me pronën e tyre, në rr. {***}, Tiranë”.

24.2/c. Në aktet e përcjella nga Komisioni gjendet edhe: (i) Kontratë për kalim të drejtash me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.01.2011, me palë A. N. (pala poseduese e të drejtave), E. Sh. “pala përfituese e të drejtave” dhe palë sipërmarrëse z. A. Xh., për kalimin e të gjitha të drejtave që pala e parë ka mbi apartamentin me sip. totale 151.44 m², kati 3, që ndërton shoqëria “{***}” ShPK, në rrugën “{***}”, dhe shuma totale që do të paguajë pala e dytë është 151.440 euro, që përfaqëson vlerën totale. Sipas

⁹ Certifikatë për vërtetim pronësie nr. {***}, dt. 07.11.2016, për apartament me sip. 138 m² me nr. pasurie {***}, ZK {***}, vol. {***}, f. {***}, rr. “{***}”, Tiranë, në pronësi të E. Sh. + Kartelë pasurie. Kontratë kalimi të drejtash nr. {***}, datë 04.01.2011, me objekt kalimin palës së dytë, palës përfituese E. Sh. e të gjitha të drejtave që pala e parë, A. N., ka mbi apartamentin nr. {***}, me sip. 151.44 m², në katin e tretë (sip. e saktë do të përcaktohet pas kolaudit të objektit) të pallatit që ndërton pala e tretë, shoqëria “{***}” ShPK. Shuma totale e paguar nga pala e dytë, palës së parë, është 151.440 euro dhe palët bien dakord për dorëzimin e apartamentit menjëherë pas nënshkrimit të kontratës. Kjo shumë është paguar deri tani shoqërisë nga pala e parë. Në deklaratën e vëllait të subjektit, shtetasi L. Sh., shpjegon se në vitin 1993, së bashku me babain dhe vëllezërit kanë blerë rreth 700 m² tokë, në rr. “{***}”, {***} dhe kanë ndërtuar një vilë 3-katëshe me 6 apartamente + një objekt jashtë saj me sip. 16 m². Pikërisht këtë objekt, me tokë 180 m² rreth tij, ia kanë dhuruar pa dokumentacion vëllait Bardhyl Shehu. L. Sh. deklaron se ka punuar 14 vite në Greqi, nga 1996 – 2010, bashkë me vëllain D. dhe për disa vite edhe me vëllain A. Të ardhurat nga puna në Greqi ia ka dërguar babait për t’i administruar. Bardhyl Shehu është martuar në vitin 1998 me E. T. dhe kanë banuar në një apartament me qira, pranë banesës së prindërve të saj, të cilët kishin nevojë për përkujdesje. Rrjedhimisht, Bardhyli nuk kishte interes të kthehej në {***}, në objektin dhe tokën e tij, ndërkohë që të gjithë vëllezërit e tjerë donin të hapnin biznes prodhim/shitje mobilierie, profesion që e kishin ushtruar edhe në Greqi e Tiranë. Për këtë arsye kanë rënë dakord që në këmbim të objektit 16 m² dhe tokës 180 m², Bardhyli të marrë nga vëllezërit A., D., H. dhe L., dhe babai Xh., shumën 181.000 euro, që përfaqëson shumën e blerjes së banesës dhe garazhit në rr. “{***}”, pallati “{***}”. Shuma e dhënë nga L. Sh. përfaqëson të ardhurat nga puna e tij në Greqi. Në vitin 2010, L. Sh. ka shkruar në Amerikë. Nxjerrje llogarie bankare e TD Bank në emër të “{***}”, me gjendje në dt. 19.10.2016, shumën 43.680 USD. Nxjerrje llogarie bankare e Citibank, në emër të L. dhe A. Sh., me gjendje në datën 16.10.2016, shumën 49.703 USD.

nenit 3 të kontratës, pala poseduese, A. N., deklaroi se ka marrë nga pala përfituese, E. Sh, shumën e mësipërme prej 151.440 eurosh dhe nuk ka pretendime, duke konfirmuar pagimin e shumës prej 151.440 eurosh deri në datën 04.01.2011. (ii) Kontratë shitje nr. {***}, datë 31.10.2016, sipas së cilës pala blerëse, znj. E. Sh, ka blerë nga shoqëria “{***}” ShPK pasurinë “apartament me sip. 138 m²”, në godinën e ndërtuar në rr. “{***}”, me çmim 151.440 euro, shumë e paguar plotësisht në zbatim të kontratës së kalimit të të drejtave reale nr. {***}, datë 04.01.2011, dhe vërtetimit të lëshuar nga shoqëria për pagesën e kryer. Në dosjen e ILDKPKI-së rezultoi e administruar edhe mandatpagesa e lëshuar nga shoqëria “{***}” ShPK, në datën 04.10.2012, në emër të znj. E. Sh, në shumën 181.440 euro, me përshkrimin “*Prenotim apartamenti 151.440 euro dhe vendparkim 30.000 euro*”.

24.3. Në kushtet kur subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi për pasuritë “apartament” dhe “garazh”, ndodhur në rrugën “{***}” të ardhurat e përfituara prej familjarëve të tij, shumën e konsiderueshme prej 180.000 eurosh, që lidhen me objektin 16 m² dhe sipërfaqen e tokës 180 m², të ndodhur në {***}, Tiranë, trupi gjykues kontrolloi deklaratimet e subjektit mbi përfitimin / shkëmbimin e pasurisë të ndodhur në Allias, duke i ballafaquar ato me dokumentacionin justifikues ligjor, si dhe analizoi burimet financiare të ligjshme të familjarëve të tij, për mundësinë e dhënies së shumës.

24.3/a. Në DIPP-në e vitit 2006, subjekti deklaroi në seksionin “pasuri të paluajtshme” se ka përfituar si dhurim nga babai: “180 m² tokë + 16 m² dhomë banimi tek {***}, e paregjistruar. Është aplikuar për regjistrim në vitin 2006”.

24.3/b. Lidhur me pretendimin e subjektit, se ka hequr dorë nga pasuria “truall me sip. 180 m²” dhe ndërtim me sip. 16 m² dhe si këmbim ka përfituar shumën prej 181.000 eurosh, trupi gjykues, në analizë të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit, konstaton se formulari i vetëdeklarimit¹⁰ të objektit për legalizim, datë 18.08.2006, dorëzuar prej subjektit, nuk përbën akt ligjor me fuqi të plotë provuese, mbi të cilin ai të bazojë pretendimet e tij mbi pronësinë e truallit, dhurimit të këtij trualli dhe ndërtimit mbi të, nga babai dhe vëllezërit e tij.

24.3/c. Ndërsa për sa i përket deklaratës noteriale, nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.06.2016, në të cilën subjekti me babain, Xh. Sh., dhe vëllezërit e tij A. Sh., D. Sh., H. Sh., L. Sh., deklarojnë se kanë marrë nga Bardhyli pronën e ndërtuar prej tyre, që i kishin dhuruar pa dokumentacion (truall 180 m² dhe ndërtesë 16 m²) subjektit, pasi donin të hapnin biznes privat për prodhim e shitje mobiliesh, e për këtë, ata i kanë dhënë në vitin 2011 shumën 181.000 euro, për blerjen e banesës e garazhit në rrugën “{***}, Tiranë, trupi gjykues konstaton se ky akt është përgatitur një ditë përpara (22.06.2016) mbajtjes së procesverbalit me inspektorët e ILDKPKI-së (23.06.2016). Pavarësisht këtij fakti, trupi gjykues vlerëson se ky dokument është i pamjaftueshëm për të provuar ekzistencën e një titulli pronësie, që i referohet një veprimi juridik për kalimin e pronësisë. Deklarata noteriale e vetme nuk përbën dokumentacion ligjor për të provuar pronësinë mbi sendin e paluajtshëm apo edhe për të legjitimuar marrëveshjen e arritur mes palëve mbi dakordësinë për shkëmbim të pronësisë mbi sendin e paluajtshëm me vlerën monetare të dhënë, pretenduar mes tyre. Për rrjedhojë, mbështetur në përcaktimet e pikës 4,

¹⁰ Vetëdeklarim për legalizim objekti, datë 18.08.2006, i subjektit Bardhyl Shehu, për banesë ekzistuese me vit ndërtimi 1993, me sipërfaqe 180 m² tokë dhe ndërtim 16 m² – sjellë nga subjekti bashkëlidhur deklaratës vetting, gjithashtu ka bashkëlidhur dhe vetëdeklarimet për legalizim të vëllait, H. Sh.

të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016 dhe pikës 19, të Udhëzimit nr. 4095, datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i pambështetur në dokumentacion justifikues ligjor dhe mbetet në nivel deklarativ dhe i paprovuar.

24.4. Trupi gjykues e konsideron të pabesueshëm dhe jo me logjikë ekonomike veprimin e pretenduar të subjektit lidhur me shkëmbimin e një dhome 16 m,² e ndërtuar mbi sipërfaqen 180 m,² ndodhur në zonën e {***}, me një apartament dhe garazh në një nga zonat qendrore të qytetit të Tiranës. Aq më tepër që sipas subjektit objekti prej 16 m² ka qenë i ndërtuar prej babait dhe vëllezërve të tij, në tokën e blerë prej babait, më pas dhuruar subjektit, pa dokumentacion, dhe në vitin 2011 e kanë shkëmbyer këtë objekt kundrejt çmimit prej 181.000 eurosh, shumë të cilën subjekti e pretendon si burim krijimi për pasuritë objekt shqyrtimi.

24.5. Trupi gjykues e vlerëson të pabazuar pretendimin e subjektit në ankim, *se vlera që është konvertuar me sipërfaqen e tokës dhe objektin, është llogaritur duke marrë në konsideratë faktin se aty do të ndërtohej një pallat,*¹¹ *kjo sipërfaqe toke është tokë truall dhe se në atë zonë janë bërë ndërtime pallatesh dhe po vijohet që edhe banesat e tjera, që e kanë hapësirën e nevojshme, siç është prona e vëllezërve të tij, t'i kthejnë në pallate.* Ky konkluzion bazohet në faktin se, edhe sikur t'u referohemi akteve që ndodhen në fashikullin e Komisionit, pikërisht duke krahasuar çmimet e një trualli të ndodhur në bulevardin “{***}”, Tiranë, ku bashkëshortja e subjektit ka qenë pjesë e këtij transaksioni (trajtuar më poshtë në këtë vendim), rezulton se vlera krahasimisht është 3 herë më e madhe.¹² Konkretisht, bashkëshortja e subjektit ka blerë, në datën 27.10.2009, e shitur në 21.08.2010 (5 muaj më parë), një truall me sipërfaqe 1.058 m,² në bulevardin “{***}”, Tiranë, kundrejt çmimit 45.094.790 lekë ose 42.623 lekë/m,² ose 323 euro/m². Ndërsa vëllezërit e subjektit, tokën prej 180 m² dhe ndërtesë 16 m² në {***}, Tiranë e kanë shkëmbyer me vlerën 181.000 euro, në vitin 2011, e kanë konsideruar¹³ në vlerën prej 1.006 euro/m². Duke marrë në konsideratë edhe vendndodhjen e truallit në bulevardin “{***}”, Tiranë, pra afër qendrës së Tiranës, si dhe konsideruar faktin që trualli në bulevardin “{***}”, Tiranë, kishte në kohën e shitjes, kontratë për zhvillimin e tij dhe ndërtimin e një ndërtese disakatëshe, vlera e shkëmbimit të truallit në {***}, me vlerën e likuiditetit 181.000 euro, në janar 2011, dhënë nga vëllezërit e subjektit, duket vlerë e konsiderueshme dhe jo reale në kushtet e tregut të kohës, për rrjedhojë, ky pretendim i subjektit të rivlerësimit është i pabazuar.

¹¹ Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 23.06.2016, subjekti, i pyetur në lidhje me likuiditetin cash në shkëmbim të pronës dhe se sa do ta vlerësonte pasurinë e tij të paluajtshme, tokë me sip. 180 m² dhe objekt 16 m², është përgjigjur se: “Nuk kam dijeni për çmimet e referencës në atë zonë. Është zonë që i përket qytetit, edhe në vitin 2011, dhe jo fshatit, pra konsiderohet tokë truall. Dua të theksoj se në atë zonë janë bërë ndërtime pallatesh dhe po vijohet që edhe banesat e tjera, që e kanë hapësirën e nevojshme, t'i kthejnë në pallate. Sa i përket vlerës që është konvertuar me sipërfaqen e tokës dhe objektin, kjo shumë është vërtet e konsiderueshme, por kjo është llogaritur ose marrë në konsideratë fakti se aty do të ndërtohej një pallat, meqenëse edhe sipërfaqja e tokës ishte e bollshme dhe mund të kishim përfitime të mëdha të konsiderueshme nga pallati”.

¹² Raporti i 1.006 euro/m,² konsideruar trualli në {***}, pjesëtuar me 323 euro/m,² vlera e truallit në bulevardin “{***}”, Tiranë.

¹³ Nëse do konsiderohej se trualli në {***} sipas verifikimit nga ALUIZNI është 144.5 m,² atëherë rezulton se është shkëmbyer me vlerën 181.000 euro ose 1.253 euro/m² e gati 4 herë (3.88 herë) më e madhe vlera për m², krahasimisht me truallin e blerë/shitur nga bashkëshortja në bulevardin “{***}”, Tiranë, kundrejt çmimit 45.094.790 lekë ose 42.623 lekë/m,² ose 323 euro/m².

24.6. Lidhur me deklarin e subjektit mbi burimin e krijimit të pasurisë “apartament dhe garazh”, nga të ardhurat e dhëna nga 4 vëllezërit e tij dhe babai, trupi gjykues vlerëson se, referuar pikave 1, 2 dhe 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës, pika 1 e nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, pika 7 e Udhëzimit datë 10.10.2016, të ILDKPKI-së, si dhe formulari i deklarimit të pasurisë për procesin e rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka pasur për detyrim deklarimin e pasurive të tij dhe të personave të lidhur në momentin e krijimit të tyre, ku me burim në këtë rast përfshihen mjetet financiare që kanë shërbyer për krijimin e tyre.

24.6/a. Trupi gjykues konstaton se në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 23.06.2016, lidhur me mundësinë financiare të vëllezërve të tij për dhënien e likuiditetit për të blerë apartamentin dhe garazhin, subjekti ka deklaruar se: *tre prej vëllezërve L. Sh., D. Sh. dhe A. Sh. për shumë vite kanë punuar në Greqi, ku L. dhe D. për 14 vite. Pjesën më të madhe të likuiditetit e ka dhënë L., të cilat i ka menaxhuar babai i tyre, në vitin 2010, L. emigroi nga Greqia në Amerikë, ku kishin motrën e tyre. Për të kontrolluar mundësinë e kursimeve për vlerën e dhënë në shumën prej 181.000 eurosh, konstatohet se në aktet e fashikullit të Komisionit gjenden disa dokumente lidhur me të ardhurat e vëllait të subjektit, L. Sh., në Amerikë (në anglisht të papërkthyer),¹⁴ por që nuk përmbajnë informacion për krijim të ardhurash nga vëllai përpara muajit janar 2011 (momenti i blerjes së apartamentit).*

24.6/b. Lidhur me mundësinë financiare të vëllezërve të tij, subjekti, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar, ashtu si dhe në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 23.06.2016, të ardhurat nga puna e vëllezërve të tij (L., D. dhe A.), por duke shtuar këtu se ka punuar për pak kohë dhe vëllai tjetër H.¹⁵. Subjekti ka bashkëlidhur dokumentet në anglisht, të cilat janë akte që i kishte dorëzuar në procesverbalin e ILDKPKI-së, por dhe lëvizje të llogarive bankare të shoqërisë së vëllait, L. Sh., në Amerikë dhe llogarisë personale të vëllait¹⁶. Trupi gjykues konstaton se ato përmbajnë informacione që i përkasin periudhës pas janarit të vitit 2011 (momenti i dhënies së likuiditetit 181.000 euro për blerjen e pasurive) dhe, për rrjedhojë, nuk provojnë mundësinë financiare të tij për dhënien e likuiditetit, për blerjen e pasurive “apartament” dhe “garazh”.

24.6/c. Në pyetësin e dytë, në datën 29.06.2023, lidhur me aftësinë paguese të vëllezërve, subjekti ka deklaruar, ashtu si dhe në procesverbalin e ILDKPKI-së, datë 23.06.2016, dhe në deklaratën *vetting*. Përveç L., D. dhe A. (nuk e përmend emrin e vëllait tjetër, H., që e deklaroi në deklaratën *vetting*), ka shtuar në këtë pyetësor se ka kontribuar dhe motra e tij, A. D. me bashkëshortin e saj, B. D., duke cituar se: *“...Në këtë shumë është përfshirë edhe një shumë lekësh të dërguara ndër vite nga motra ime A.D. (Sh.), vetë dhe bashkëshortit, B. D., dhe të afërmeve të këtij të fundit. Shuma e lekëve është dhënë bashkëshortes time cash nga babai im, i cili ka menaxhuar gjithë shumën e lekëve që i janë sjellë ndër*

¹⁴ Certifikatë për regjistrimin e shoqërisë “{***}”, kopje të numrit të sigurimeve të L. Sh., datë 04.11.2011, adresën e shoqërisë “{***}”, si dhe certifikatë “specimen” të “{***}”.

¹⁵ Bashkëshortja e subjektit, ndër të tjera, shprehet: “...Sa i përket aftësisë paguese, deklaroj se 2 nga vëllezërit e bashkëshortit kanë punuar prej rreth 14 vitesh në emigracion dhe për rreth 5-6 vite ka punuar edhe vëllai tjetër i tyre A., e për pak kohë ka punuar edhe vëllai tjetër, H. Dokument tjetër justifikues - për aftësinë paguese të njërit prej vëllezërve, L. Sh., i cili, në vitin 2010, ka emigruar në USA (kopje të llogarisë bankare, nr. punës, biznesit etj.)”.

¹⁶ Lëvizje të llogarive bankare (në anglisht) të shoqërisë “{***}” në TD Bank, për lëvizjet e llogarisë nga 04.10.2016 deri në 19.10.2016, me balancë 43.680,44 USD, si dhe llogarisë bankare të L. Sh., në Citibank N. A., për lëvizjet e llogarisë nga 16.09 – 16.10.2016, me balancë 49.703,89 USD.

vite nga vëllezërit nga emigracioni, dhe ka qenë personi garant i kësaj marrëveshje të lidhur mes nesh. Nuk kam dokumente për mënyrën e dërgimit të lekëve. (Bashkëlidhur ju dërgojmë disa dokumente,¹⁷ që provojnë aftësinë paguese të vëllait tim, L. Sh., dhe motrës, A. D., që jetojnë në USA.)”. Subjekti i rivlerësimit ka bashkëlidhur dhe dokumente në anglisht (pa përkthyer), për motrën e tij, A. D., dhe bashkëshortin e saj, B. D.¹⁸

24.6/ç. Trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni, vlerëson se shtimi i emrit të motrës si kontribues në likuiditetin prej 181.000 eurosh, të dhënë subjektit (në këmbim të tokës dhe objektit në {***}), për blerjen e pasurive “apartament e garazh”, në janar 2011, vetëm gjatë procesit në Komision dhe specifikisht pas përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, është në kundërshtim me deklaratimet e tij më parë, në deklaratën para fillimit të funksionit në vitin 2013, në deklaratën noteriale datë 22.06.2016, me vëllezërit dhe babain, si dhe në deklaratën *vetting*, ku referon si burim se likuiditeti është dhënë vetëm nga 4 vëllezërit dhe babai, që ka menaxhuar likuiditetin.

24.6/d. Lidhur me të ardhurat e vëllezërve konstatohet se Komisioni ka administruar shkresën nr. {***} prot., datë 26.06.2023, të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, në të cilën konfirmohet se vëllai D. Sh. ka aktivitet tregtar për “skela për ndërtim me qira”, të regjistruar në datën 16.09.2015 dhe informacion pas kësaj date për aktivitetin tregtar të tij, ndërsa vëllai H. Sh. rezulton deklarues në DIVA në vitin 2020. Sikurse vërehet, këto informacione lidhen me periudha pas dhënies së likuiditetit prej 181.000 eurosh, në janar të vitit 2011 (blerjen e apartamentit dhe garazhit), për rrjedhojë, nuk janë relevante në drejtim të provimit të mundësisë financiare të vëllezërve të subjektit.

24.7. Nga sa më lart, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit nuk ka provuar me dokumentacion ligjor provues, as me plotësimin e deklaratës *vetting* dhe as gjatë hetimit administrativ në Komision, mundësinë financiare të vëllezërve dhe të babait, për krijimin me burime të ligjshme të shumës prej 181.000 eurosh. Për rrjedhojë, vetëm fakti që burimi i krijimit është deklaruar në deklaratat noteriale, të cilat në themel bazohen në thënie të palëve, nuk nënkupton apo provon ekzistencën e burimit të ligjshëm në sasinë apo rrethanat e deklaruara. Lidhur me pretendimet e subjektit dhe dokumentacionin e depozituar për vëllain e tij, L. Sh., rezulton se ato përmbajnë të dhëna për të ardhurat e tij, që i përkasin periudhës pas janarit të vitit 2011, kështu, duke mos provuar mundësinë financiare lidhur me pagimin e shumës prej 181.000 eurosh, deri në janar të vitit 2011.

24.8. Trupi gjykues i Kolegjit çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka arritur të provojë pretendimet e tij për të ardhurat e babait apo të vëllezërve nga punësimi, qoftë për nga ekzistenca e tyre, vlera konkrete, si dhe ligjshmëria e tyre, nën dritën e kriterit të përcaktuar nga kërkesat e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe Udhëzimit të Inspektorit të Përgjithshëm të IKDKPKI-së

¹⁷ Konstatohet se subjekti ka bashkëlidhur dhe një herë dokumentet në anglisht (pa përkthyer) për vëllain L. Sh., si dhe akte shitesë, që lidhen me të ardhurat e tij në vitin 2017, e ku rezulton se vëllai është i martuar dhe me dy fëmijë, të dhëna për kredi në vitin 2021, të cilat nuk provojnë mundësinë financiare të tij për dhënie të likuiditetit në janar 2011, prej 181.000 eurosh, pasi dokumentet kanë informacione e indicie pas kësaj date (janar 2011).

¹⁸ Pasaportat e tyre amerikane; certifikatë për regjistrimin e shoqërisë “{***}” nga kunati i subjektit, B. D., në janar 2006; lëvizje bankare të “{***}”, në Commerce Bank, për 31.07 – 31.08.2006, me balancë 4.705,78 USD, adresën e shoqërisë “{***}”, si dhe lëvizje bankare të “{***}”, në TD Bank, për 01.05 – 31.05.2023, me balancë 144.121,2 USD.

nr. 4095/2016, si dhe jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit në çështje të trajtuara ndër vite, për të ardhurat e pretenduara me prejardhje nga emigracioni¹⁹.

24.9. Shuma prej 181.000 eurosh, e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit si e dhënë prej babait dhe vëllezërve të tij, në shkëmbim të tokës dhe objektit të ndodhur në {***}, referuar vlerës së madhe të saj dhe pa logjikë ekonomike për veprimin e kryer, nuk u shoqërua me asnjë akt provues të kohës dhe as me gjurmë mbi ekzistencën e saj në llogari bankare, element që jo vetëm do të legjitimonte ligjshmërinë e veprimit për përfitimin e të ardhurave prej 181.000 eurosh, në kuptim të nenit 3, pika 19 e ligjit nr. 84/2016, por edhe do të rriste besueshmërinë rreth ekzistencës së kësaj marrëdhënieje në kohën e pretenduar.

24.10. Në përmbledhje të sa më sipër, referuar fakteve dhe provave lidhur me pasuritë objekt analize, trupi gjykues e vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit, se transaksionet e pretenduara dhe dokumentacioni ligjor i hartuar nga subjekti i rivlerësimit me vëllezërit dhe babain e tij mbetën në nivel deklarativ dhe të paprovuara nga ana ligjore e financiare, dhe se ato janë hartuar vetëm me qëllim justifikimin e mungesës së burimit të ligjshëm të krijimit të shumës së përdorur nga subjekti i rivlerësimit, që ka shërbyer si burim krijimi për këto pasuri.

24.11. Lidhur me pasurinë “garazh me sip. 18.6 m²”, personi i lidhur me subjektin, bashkëshortja, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar: *“Garazh me sip. 18.6 m², nr. pasurie {***}, vol. {***}, f. {***}, z. k. {***}, me adresë rr. “{***}”, pallati “{***}” (nën tokë), Tiranë. Vlera: 30.000 euro, pjesa 100%”*. Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të njëjtin burim krijimi për këtë pasuri ashtu si edhe për apartamentin.

Në DIPP-në 2013, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar: *“Vendparkim me nr. {***}, në katin e dytë nëntokë, me sip. 6.12 m². Burimi i krijimit: 4 vëllezërit e bashkëshortit për shkakun e përmendur edhe në apartament. Vlera: 25.000 euro. Pjesa 100%”*.

24.11/a. Komisioni, gjatë hetimit, ka administruar edhe përgjigjen e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (në vijim ASHK), Drejtoria Vendore Tirana Jug, e cila konfirmon të regjistruar në emër të znj. E. Sh pasurinë “garazh me sip. 18.6 m²”, nr. pasurie {***}, vol. {***}, f. {***}, z. k. {***} me kontratë shitjeje nr. {***}, datë 31.10.2016. Në kartelën e pasurisë pasqyrohet adresa: rruga “{***}”, Tiranë dhe shuma e paguar, 25.000 euro.

24.11/b. Në mbështetje të shpjegimeve, subjekti ka depozituar: (i) kontratë për kalim të drejtash nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.01.2011, për garazhin nr. {**}; (ii) deklaratë noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.04.2011, për revokimin e kontratës për kalim të drejtash nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.01.2011; (iii) Kontratë sipërmarrje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 08.06.2011, sipas së cilës shoqëria “{***}” ShPK merr përsipër të ndërtojë godinën në rrugën “{***}” dhe t’i dorëzojë

¹⁹ Shih, ndër të tjera, vendimin: nr. 12/2008 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit B. D.; nr. 09/2018 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit A. Xh.; nr. 15/2019 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit D. Rr.; nr. 06/2019 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit A. S.; nr. 32/2019 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit B. M.; si dhe nr. 14/2021 (JR), që i përket subjektit të rivlerësimit I. B., në: <https://kpa.al/juridiksion-rivleresimi-vendime/>

porositësit, E. Sh, vendparkimin nr. {***}, për të cilin duhet të derdhë shumën 25.000 euro; (iv) certifikatë për vërtetim pronësie për garazhin nr. {***}.

24.11/c. Megjithëse nga aktet rezultoi se është nënshkruar një kontratë kalim të drejtash, nr. {***}, datë 04.01.2011, sipas së cilës parashikohet se pala e parë, A. N. - shitësi, deklaroi se ka marrë nga pala e dytë, bashkëshortja e subjektit, E. Sh, shumën 30.000 euro, për garazh/vendparkim nr. {***}, u provua se kjo kontratë është revokuar me mirëkuptim të të dyja palëve, sipas deklaratës noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 22.04.2011.

24.11/ç. Sa më sipër, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar saktë në deklaratën e pasurisë *vetting* vlerën e garazhit prej 30.000 eurosh, pasi nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit, si dhe në DIPP-në e vitit 2013, personi i lidhur me subjektin ka deklaruar se vlera e garazhit është 25.000 euro.

24.11/d. Për sa i përket burimit të krijimit të pasurisë “garazh”, për sa kohë subjekti ka deklaruar të njëjtën burim krijimi për këtë pasuri, ashtu si edhe për apartamentin, qëndron arsyetimi i mësipërm i trupit gjykues lidhur me mungesën e dokumentacionit justifikues ligjor nga subjekti i rivlerësimit për të provuar ligjshmërinë e burimit për shumën prej 181.000 eurosh, dhënë nga babai dhe vëllezërit e subjektit.

24.12. Në përfundim, për pasuritë “apartament me sipërfaqe 138 m²”, blerë me çmim 151.440 euro dhe “garazh me sip. 18.6 m²”, blerë me çmim 30.000 euro, me çmim total në vlerën 181.000 euro, të ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, trupi gjykues e vlerësoi të drejtë konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e këtyre pasurive, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, germat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 84/2016.

25. Lidhur me pasurinë “automjet”, tip “Mercedes-Benz”, me targë {*}, blerë në vlerën 2.000 euro**

25.1. Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë “automjet”, referuar vlerës reale të paguar prej tij dhe ndodhet në kushtet e pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë këtë pasuri dhe të justifikojë burimet e ligjshme, duke u ndodhur në situatën faktike të përcaktuar nga germat “a”, “b” dhe “ç”, të pikës 5, të nenit 33 dhe pikës 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016.

25.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit është i gabuar, pasi lekët për blerjen e automjetit i ka paguar kunati i tij, A. T., i cili për këtë fakt ka lëshuar edhe një deklaratë noteriale. Nga shpjegimet që i ka dhënë kunati për këtë problematikë, që është konstatuar nga Komisioni, ai është shprehur se në kontratë është vënë një çmim i tillë, për shkak se me shitësin, P. D., ata kanë pasur marrëdhënie pune/biznesi, dhe kaq ishte detyrimi që ka pasur ndaj tij (kunatit), duke llogaritur edhe vlerën e automjetit. Subjekti pretendon se nuk ka pasur asnjë marrëdhënie pune dhe as marrëdhënie tjetër të çfarëdoshme me shitësin e automjetit.

25.2/a. Subjekti pretendon se burimi i të ardhurave të kunatit, A. T., ka qenë biznesi i tij. Për të provuar këtë fakt, ka vënë në dispozicion, bashkëlidhur shpjegimeve të pyetësorit të dytë, edhe një deklaratë të

lëshuar nga vetë pronari i automjetit, shtetasi P. D. Subjekti sqaron se arsyeja e pagesës së vlerës së automjetit prej kunatit ka qenë se, nga viti 1998 deri në vitin 2013, ai së bashku më bashkëshorten kanë jetuar/banuar pranë prindërve të bashkëshortes, në një banesë me qira, ngjitur me apartamentin e tyre. Në këtë kontekst, edhe vlera e automjetit është paguar nga kunati, me qëllim më tepër për t'u shërbyer prindërve të tij të sëmurë, të cilët kishin nevojë që të shkonin herë pas here në spital.

25.3. Trupi gjykues, në analizimin e pretendimit të subjektit të rivlerësimit lidhur me këtë pasuri, analizoi dokumentacionin e ndodhur në fashikujt e Komisionit, ku i rezultoi se:

25.3/a. Në deklaratën e pasurisë *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *“Makinë, Mercedes-Benz, me targë {***}, prodhim i vitit 2000. Blerë në shumën 2.000 euro, sipas kontratës së shitblerjes nr. {***}, datë 31.01.2008. Zhdoganuar më datë 28.01.2008. Paratë janë dhuruar nga kunati im/vëllai i gruas, A. T., i cili është biznesmen dhe administrator i shoqërisë ‘{***} ShPK (PPA) me nr. identifikimi {***}”.*

Në deklaratën periodike 2008, subjekti ka deklaruar: *“Makinë Mercedes-Benz 2000, me targë {***}, blerë nga shtetasi P., me lekë të dhuruara nga kunati im, A. T., në shkurt 2008”.*

25.3/b. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 23 qershor 2016, subjekti ka deklaruar: *“... Në familje kemi vetëm automjetin si më sipër, me targë {***}. Në bazë të kontratës së blerjes, vlera e automjetit është në shumën 2.000 euro dhe këtë likuiditet e kam marrë nga kunati im, deklaratë të cilën e paraqita për t'u administruar në dosje”.*

25.3/c. Në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se: *“Në vitin 2008 më është dhuruar një makinë Mercedes-Benz, me targë {***}, prodhim i vitit 2000, blerë në shumën 2.000 euro. Paratë janë dhuruar nga kunati im/vëllai i gruas, A. T., i cili është biznesmen dhe administrator i ‘{***}’ ShPK”.*

25.3/ç. DPSHTR-ja, me shkresën nr. {***} prot., datë 29.01.2021, ka vendosur në dispozicion të Komisionit dosjen e automjetit, në të cilin ndodhen: (i) certifikata e pronësisë së automjetit në emër të Bardhyl Xh. Shehut, për automjetin “Mercedes-Benz” 200, vit prodhimi 2000; (ii) kontratë shitblerjeje automjeti nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.01.2008, me shitës P. D. dhe blerës Bardhyl Xh. Shehu, për automjetin e markës “Daimler Chrysler”, kundrejt çmimit 2.000 euro; (iii) faturë shitblerjeje në emër të P. D., që konfirmon blerjen e automjetit në datën 15.01.2008; (iv) deklaratë doganore nr. {***}, datë 28.01.2008, ku vlera e këtij mjeti është 4.300 euro dhe shpenzimet doganore kanë qenë në vlerën 314.835 lekë.

25.4. Trupi gjykues, mbështetur në të dhënat e rezultuara nga hetimi administrativ dhe në deklaratimet e mësipërme të subjektit, mori në shqyrtim pretendimin e këtij të fundit, *se qëndrimi i Komisionit lidhur me vlerën/çmimin e kësaj pasurie, nuk përputhet me provat dhe situatën faktike.* Siç rezulton nga deklarimi i subjektit në deklaratën *vetting*, vlera e automjetit është 2.000 euro, sipas kontratës së shitjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 31.01.2008, ndërkohë referuar dokumentacionit të ndodhur në fashikull, specifikisht aktit të zhdoganimit sjellë nga subjekti bashkëlidhur deklaratës *vetting* (aneksi 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së), si dhe akteve mbledhur gjatë hetimit në Komision nga DPSHTRr-ja, rezulton se shitësi (4 ditë para shitjes) ka shpenzuar për blerjen e automjetit vlerën 4.300 euro dhe për

zhdoganimin e tij vlerën 314.835 lekë, pra vlera reale e momentit kur është blerë automjeti, ka qenë 838.489 lekë. Trupi gjykues, duke marrë në konsideratë vlerën e shpenzuar prej shitësit (838.489 lekë), ashtu si Komisioni, krijon dyshimin se kontrata e shitblerjes, e lidhur nga subjekti me shitësin P. D., në vlerën 2.000 euro, është bërë për të shmangur deklarimin e vlerës së plotë të automjetit. Në kushtet kur automjeti është zhdoganuar 4 (katër) ditë përpara se t'i shitej subjektit, mundet që subjekti të ketë paguar vlerën e plotë të këtij automjeti, e cila nga hetimi rezultoi se ishte 838.489 lekë.

25.5. Lidhur me pretendimet e subjektit mbi çmimin e automjetit, duke iu referuar marrëveshjeve të mëparshme apo detyrimeve mes shitësit të automjetit dhe kunatit të tij, trupi gjykues konstaton se ato nuk provohen nga dokumentacioni ligjor i hartuar mes palëve, siç është kontrata e shitblerjes. Madje as në deklaratën noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 10.06.2016, të shtetasit A. T., i cili deklaroi vetëm dhënien e shumës prej 2.000 eurosh për blerjen e një automjeti, nuk përmenden rrethana të tjera në lidhje me çmimin apo marrëdhënie biznesi me shitësin P. D., ashtu sikurse pretendon subjekti i rivlerësimit. Gjithashtu, gjatë hetimit administrativ, kur subjekti është pyetur në pyetësorin nr. 2 mbi ndryshimet e çmimit të automjetit, ai nuk ka mundur të paraqesë një panoramë më të detajuar apo të sillte akte (kontrata bashkëpunimi, fatura etj.), ku të vërtetonte marrëdhënien e punës/biznesit, të kunatit A. T. me shitësin P. D., apo dhe marrëveshje/deklaratë/kontratë e palëve për përmbylljen e detyrimeve me njëri-tjetrin.

25.6. Lidhur me deklaratën noteriale të shitësit të automjetit, P. D., të përmendur në vendimin e Komisionit (pa ekstremite), trupi gjykues konstaton se ajo është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, dhe prezantohen fakte të konceptuara në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, e për rrjedhojë, bazuar edhe në qëndrimet që ka mbajtur Kolegji në çështje të ndryshme, fuqia provuese e saj në këtë proces nuk është bindëse, në raport me të dhënat që paraqiten në kontratën e shitblerjes së automjetit dhe deklaratën doganore.

25.7. Nga sa më lart, trupi gjykues e vlerëson të drejtë qëndrimin e Komisionit, se automjeti është blerë nga subjekti në vlerën 838.489 lekë, dhe se deklarimi i vlerës së automjetit në deklaratën *vetting* dhe dokumentacioni i hartuar është bërë vetëm për të justifikuar burimin e krijimit të kësaj pasurie të luajtshme prej tij.

25.8. Trupi gjykues, pasi konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në vijimësi në deklaratat periodike të kohës, por edhe gjatë procesit të tij të rivlerësimit, se si burim për krijimin e pasurisë “automjet” ka shërbyer dhurimi nga kunati, A. T. (vëllai i bashkëshortes), kontrolloi dokumentacionin e administruar në Komision lidhur me të ardhurat e A. T. dhe konstaton se:

25.8/a. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar²⁰ në Komision: (i) vendim nr. {***}, për regjistrimin e personit juridik “{***}” ShPK, me ortak të vetëm A. T.; (ii) certifikatë regjistrimi e personit të tatueshëm “{***}” ShPK, akte të cilat nuk tregojnë apo vërtetojnë të ardhurat e ligjshme të A. T. Gjithashtu

²⁰ Subjekti i rivlerësimit ka depozituar gjithashtu: (i) shkresë nr. {***} datë 27.06.2023, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (ish-Prokuroria Krujë), që konfirmon se subjekti nuk ka ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale me shtetasin P. D.; (ii) shkresë nr. {***}, datë 29.06.2023, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Lezhë (ish-Prokuroria Kurbin), që konfirmon se subjekti nuk ka ndjekur materiale kallëzuese apo procedime penale me shtetasin P. D.

konstatohet se subjekti ka dorëzuar në ILDKPKI, me procesverbalin e datës 23.06.2016, deklaratat DIVA të A. T., por që i përkasin viteve 2014 dhe 2015, pra pas periudhës së dhurimit të automjetit në vitin 2008. Ndërsa shkresa nr. {***} prot., datë 24.08.2017, e Drejtorisë Rajonale Tatimore Tiranë, dërguar ILDKPKI-së, konfirmon xhirot dhe fitimet e realizuara nga shoqëria "{***}" ShPK, për vitet 2003 – 2007, por referon se nuk ka shkresë zyrtare apo dokument lidhur me shpërndarjen e dividendit, çka do të ndihmonte në identifikimin dhe verifikimin e të ardhurave të kumatit të subjektit, A. T. Subjekti, me prapësimet e rezultateve hetimore, ka bashkëlidhur një kërkesë drejtuar Drejtorisë Rajonale Tatimore, datë 28.06.2023, në të cilën i ka kërkuar të dhëna për bizneset e familjarëve të tij, ndër to dhe për A. T., por në dosje mungon përgjigja nga ky institucion.

25.9. Nga sa më lart, trupi gjykues çmon se subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë, me dokumentacion justifikues ligjor, mundësinë financiare të dhuruesit A. T. për shumën e dhuruar, për blerjen e automjetit nga subjekti. Për rrjedhojë, i ndodhur në këtë marrëdhënie dhurimi me kunatin e tij, subjekti i rivlerësimit nuk ka përmbushur detyrimin e pikës 4, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit, persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.

25.10. Subjekti i rivlerësimit ka dështuar të provojë të kundërtën e konkluzioneve të Komisionit, se ka lidhur një kontratë për blerjen e automjetit objekt analize, me qëllim justifikimin e burimit të ligjshëm të krijimit të pasurisë. Trupi gjykues vlerëson se transaksioni për blerjen e këtij automjeti konsiderohet një veprim financiar i pajustificuar, përderisa kontrata e lidhur mes palëve për blerjen e automjetit përcakton një çmim më të ulët se ai që përcaktojnë aktet e administruara në Komision për këtë pasuri. Konkretisht rezulton se shitësi (4 ditë para shitjes) ka shpenzuar për blerjen e automjetit vlerën 4.300 euro dhe për zhdoganimin e tij vlerën 314.835 lekë, pra vlera reale në momentin kur është blerë automjeti, ka qenë 838.489 lekë, ndërsa kontrata referon çmimin 2.000 euro.

25.11. Në vijim të kësaj analize, trupi gjykues konstaton se shpjegimet që subjekti i rivlerësimit ka dhënë, në lidhje me çmimin e vendosur për këtë automjet, janë kontradiktore dhe të paarsyeshme, ato nuk bindin për vërtetësinë e deklarimit të tij, por ngrenë dyshime për paraqitjen e rrethanave të rreme, të cilat tentojnë të fshehin nga kontrolli apo verifikimi çmimin real të paguar prej tij për këtë pasuri, për më tepër që subjekti rezulton me mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e pasurisë "automjet". Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë në deklaratën *vetting*, për sa i përket çmimit të blerjes dhe natyrës së marrëdhënies juridike, nëpërmjet së cilës ai ka përfituar burimin për krijimin e pasurisë.

25.12. Në përfundim, për pasurinë "automjet", tip "Mercedes-Benz", me targë {***}, blerë në vitin 2008, me vlerë 2.000 euro, trupi gjykues e vlerësoi të drejtë konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj pasurie, referuar vlerës reale të paguar prej tij, si dhe është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë këtë pasuri, duke u ndodhur në situatën faktike të parashikuar në nenin 33, pika 5, gerrat "b" dhe "ç", të ligjit nr. 84/2016.

26. Për pasurinë “truall me sipërfaqe 1.058 m,²” të ndodhur në bulevardin “{***}”, Tiranë, blerë nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, me çmim 45.094.790 lekë, në datën 07.10.2009 dhe shitur në datën 21.08.2010, me të njëjtin çmim

26.1. Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit nuk ka mundur të provojë të kundërtën e barrës së provës edhe lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e kësaj pasurie dhe mosdeklarimin e tyre në deklaratën *vetting*, duke u ndodhur në kushtet e pikës 5, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

26.2. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konkluzioni i Komisionit është i gabuar dhe i pabazuar në fakte, pasi: (i) bashkëshortja e tij ka nënshkruar kontratën për blerjen e truallit në mirëbesim, si “përfaqësuese” e vëllait të saj, për shkak se ky i fundit, ato ditë nuk kishte mundësi të vinte në Tiranë dhe se palët shitëse, gjithsej 8 persona, nuk mund të ishin të disponueshëm ditë tjetër për t’u paraqitur te noteri; (ii) bashkëshortja e tij nuk ka kryer asnjë pagesë nga shuma që figuron në kontratën e shitblerjes, kur ka blerë truallin dhe nuk ka asnjë dijeni se në ç’mënyrë i janë dhënë lekët shitësve të truallit, ndërkohë që vëllai i bashkëshortes është biznesmen.

26.2/a. Subjekti pretendon se këto veprime janë kryer në periudhën kur ai nuk ka qenë subjekt deklarimi dhe 3 vjet para se të fillonte detyrimi për deklarim; blerja dhe më pas shitja janë kryer brenda një harku kohor të shkurtër (disa muaj), në periudhën kur ai nuk kishte detyrim për deklarim; referuar faktit se nënshkrimi në kontratë ishte në mirëbesim, nuk e ka fiksuar këtë moment të nënshkrimit të kontratës së shitjes si bashkëshort/familjar i shitësit dhe nuk e ka mbajtur mend që ta deklaronte në DIPP-në para fillimit të detyrës, në muajin shkurt 2013, dhe as në vazhdimësi në DIPP-të periodike vjetore, as në deklaratën pasurisë *vetting*. Subjekti pretendon se është e pamundur të mos e deklaronte një gjë të tillë, kur bëhet fjalë për një pronë të paluajtshme, me një vlerë të konsiderueshme, e cila regjistrohet, shënohet dhe dokumentohet në disa institucione, si ZVRPP, zyra noterie etj., përveçse për arsyet e renditura më lart.

26.2/b. Sa i përket burimit të të ardhurave lidhur me këto transaksione, subjekti pretendon se familja e tij nuk është përfshirë fare në dhënien apo marrjen e lekëve, respektivisht nga blerja dhe shitja e pronës, pasi me këtë është/duhet të jetë marrë vëllai i bashkëshortes. Në mbështetje të këtij argumenti, ai ka dorëzuar vërtetim datë 29.06.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Dhoma Civile), sipas të cilit, vëllai i bashkëshortes së tij, A. T., është në proces gjyqësor për pasurinë e lartpërmendur, me shoqërinë “{***}” ShPK.

26.3. Në funksion të shqyrtimit të këtij shkakui ankimi, trupi gjykues mori në analizë qëndrimin e Komisionit mbi përpjekjen e subjektit të rivlerësimit për të deformuar të vërtetën në funksion të paraqitjes së të dhënave, të cilat do ta shpëtonin atë nga situata që lidhej me justifikimin e burimeve të ligjshme të kësaj pasurie. Konkretisht për këtë pasuri, trupi gjykues analizoi dokumentacionin e ndodhur në fashikujt e Komisionit, ku rezultoi se:

(i) Me kontratën e shitblerjes nr. {***}, datë 07.10.2009, personi i lidhur me subjektin, znj. E. Sh, ka blerë nga 8 bashkëpronarë një truall me sip. 1.058 m², në bulevardin “{***}”, kundrejt çmimit 45.094.790 lekë; (ii) Me kontratën e sipërmarrjes për dhënie trualli në ndërtim, datë 27.10.2009, me nr.

{***} rep., nr. {***} kol., me objekt “Realizimin, investimin dhe ndërtimin e një objekti godinë polifunkionale”, znj. E. Sh (në cilësinë e pronarit të truallit) ka vendosur në dispozicion të shoqërisë “{***}” ShPK pasurinë “truall”, me qëllim që kjo e fundit, në bazë të lejes së ndërtimit që do të miratohet nga KRRt-ja, të bëjë ndërtimin e godinave shumëkatëshe, duke përfituar pronari i truallit 38% të sipërfaqes së ndërtimit dhe ambienteve të përbashkëta; (iii) Me kontratën e shitblerjes datë 21.08.2010, bashkëshortja e subjektit, E. Sh, i ka shitur shtetasit L. M., në cilësinë e administratorit të shoqërisë “{***}” ShPK, pasurinë e sipërcituar “truall me sip. 1.058 m²”, në bulevardin “{***}”, kundrejt çmimit 45.094.790 lekë, me detyrimin që pala blerëse të respektojë të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga kontrata e sipërmarrjes me shoqërinë. Subjekti ka firmosur te kjo kontratë shitjeje (si dhënës pëlqimi për shitjen e truallit).

26.4. Nga sa më lart, sa i takon pretendimit të subjektit të rivlerësimit, se nuk ka pasur dijeni për kryerjen e veprimeve noteriale të bashkëshortes së tij, trupi gjykues, referuar kontratës së shitjes së kësaj pasurie në vitin 2010, konstaton se vetë subjekti e ka nënshkruar atë, fakt ky që nuk mund të kalohej si pa rëndësi nga vëmendja e subjektit, në kushtet që veprimi juridik lidhet me një akt ligjor, ndërkohë që ai është njohës i mirë i ligjit. Gjithashtu, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit nuk duken të besueshme, në kushtet kur bashkëshortja e tij ka firmosur dhe një tjetër kontratë sipërmarrje, datë 27.10.2009, për ndërtimin mbi truallin të ndodhur në qendër të qytetit të Tiranës ({***}), nga i cili do të përfitonte 38% të sipërfaqes së ndërtimit. Në këtë mënyrë konfirmohet fakti se subjekti ka pasur dijeni të plotë të veprimeve ligjore dhe financiare të kryera nga personi i lidhur me të, për transaksionet e shitblerjes së pasurisë dhe vlerave monetare përkatëse, për rrjedhojë, pretendimet e subjektit janë të pabazuara.

26.5. Sa i përket akteve të paraqitura në Komision prej subjektit në cilësinë e provës në mbështetje të argumenteve se familja e tij nuk është përfshirë në dhënien apo marrjen e lekëve, respektivisht nga blerja dhe shitja e pronës si: (i) deklaratë,²¹ datë 15.07.2023, të kunatit të tij, A. T.; (ii) kontratë sipërmarrjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 13.03.2008, lidhur midis 8 bashkëpronarëve në cilësinë e pronarëve të truallit dhe palëve sipërmarrëse, shoqëria “{***}” ShPK, përfaqësuar nga administratori i saj A. T. dhe shoqëria “{***}” ShPK, përfaqësuar nga administratorët E. M. dhe L. M.; (iii) vërtetim lëshuar në datën 29.06.2023, nga Gjykata e Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm Tiranë (Dhoma Civile), që konfirmon se shtetasi A. T. është në proces gjyqësor për pasurinë e lartpërmendur me shoqërinë “{***}” ShPK, trupi gjykues çmon se këto akte janë të pamjaftueshme për të provuar pretendimin e tij.

26.6. Ky konkluzion bazohet në faktin se subjekti i rivlerësimit, si gjatë hetimit administrativ në Komision, ashtu edhe më pas, dështoi të provojë me dokumentacion justifikues ligjor të kundërtën e të dhënave që pasqyrojnë kontratat e shitblerjes të nënshkruara nga bashkëshortja e tij. Trupi gjykues vëren se, sipas kontratës së shitblerjes cituar më lart, palët kanë rënë dakord për çmimin e sendit dhe mënyrën

²¹ Në deklaratën datë 15.07.2023, vëllai i bashkëshortes, shtetasi A. T., ndër të tjera, deklaron: “Në vitin 2008, pasi kisha hyrë në bisedime me pronarët e një trualli tek {***}, kishim rënë dakord që unë ta blija këtë pronë. Në datën 07.10.2009 kishim rënë dakord që të paraqiteshim te noteri për të nënshkruar kontratën e shitblerjes. Meqenëse atë ditë nuk kisha asnjë mundësi të vija në Tiranë, në kushtet kur pala shitëse, që ishin gjithsej 8 persona, nuk mund të ishin të disponueshme, i kam thënë motrës time, E. T., që të shkonte të firmoste kontratën në mirëbesim. Më pas, në vitin 2010, është bërë shitja e këtij trualli shoqërisë “{***}” dhe se edhe në këtë rast motra ime ka nënshkruar sërish në mirëbesim, për shkak të veprimit të mësipërm. Deklaroj se motra ime nuk ka përfituar asgjë nga kjo pronë. Deklaroj se as kunati im, Bardhyl Shehu, nuk ka lidhje me këtë pronë”.

e pagesës dhe dispozitat e kontratës, që parashikojnë kushtet thelbësore të saj²², kanë forcën e ligjit dhe duhet të respektohen prej tyre. Kontrata është akt provues, dokument ligjor që provon jo vetëm që fakti juridik ka ndodhur, por edhe që të dhënat e përcaktuara në kontratë për ndodhjen e faktit juridik janë ato të përshkruara nga palët nënshkruese në kontratë. Për rrjedhojë, kontrata dhe veprimet e mëpasshme për kalimin e pronësisë së sendit provojnë që ndërmjet palëve (E. Sh, bashkëshortes së subjektit) ka një marrëdhënie juridike për kalimin e pronësisë së sendit dhe kjo marrëdhënie është konkretizuar në vlerën 45.094.790 lekë, e cila i është paguar shitësve e plotë deri në datën 07.10.2009, dhe se palët, me nënshkrimin e kontratës dhe kalimin e pronësisë, nuk kanë pasur më asnjë pretendim.

26.7. Gjithashtu, nga kontrolli i akteve rezulton se subjekti nuk ka paraqitur ndonjë dokument që të provonte apo të kishte gjurmë për likuiditetin - çmimin e blerjes të poseduar apo paguar nga të tjerë dhe jo nga bashkëshortja e tij, E. Sh, si dhe në momentin e shitjes së pronës prej saj. Referuar kontratës së blerjes së pasurisë, datë 07.10.2009, E. Sh nuk rezulton të jetë si përfaqësuese e vëllait të saj, A. T., me akt noterial, prokurë përfaqësimi, për të vepruar në emër të tij. Nga aktet e dosjes konstatohet se bashkëshortja e subjektit, E. Sh, në momentin e blerjes së pasurisë “truall” (07.10.2009) nuk rezultoi të ishte punonjëse apo administratore ose me ndonjë pozicion në shoqërinë e vëllait të saj, “{***}” ShPK, me të cilën pronarët e truallit kishin lidhur një kontratë sipërmarrje në datën 13.03.2008. Subjekti nuk ka deklaruar se bashkëshortja e tij ka qenë punonjëse apo bashkëpunëtoresh me të vëllain e saj, A. T., madje në atë kohë, sipas lëvizjeve të llogarisë bankare në OTP Bank, E. T. ka qenë punonjëse në një shoqëri tjetër “{***}” ShA, për rrjedhojë, pretendimi i subjektit është i pabazuar.

26.8. Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit, *se me përfaqësuesin e shoqërisë “{***}” ShPK apo punonjës të tjerë të kësaj shoqërie dhe me pronarët e truallit (L. H., E. R., M. R., J. R., F. R., V. R. dhe Dh. D.), që figurojnë në kontratë si “shitës”, nuk ka pasur asnjë marrëdhënie pune dhe as marrëdhënie tjetër të çfarëdoshme, nuk është takuar asnjëherë me ta, si edhe nuk ka hetuar apo trajtuar asnjë çështje me personat e lartpërmendur*, trupi gjykues konstaton se Komisioni nuk i ka kaluar subjektit barrë prove për këtë shkak, madje nuk ka hetuar në drejtim të ekzistencës së konfliktit të interesit të tij me këta shtetas. Për rrjedhojë, ky shkak ankimi nuk paraqet relevancë në zgjidhjen e çështjes.

26.9. Trupi gjykues, pasi kontrollon deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në ILDKPKI, konstaton se Bardhyl Shehu është larguar nga funksioni në datën 02.09.2009 dhe ka dorëzuar deklaratën “*Pas largimit nga funksioni*”, në datën 25.05.2010. Kjo pasuri (trualli në bulevardin “{***}”), që bashkëshortja e subjektit ka poseduar me dokumentacion ligjor për periudhën 07.10.2009 – 21.08.2010 (gati 10 muaj), nuk është deklaruar prej tij në këtë deklaratë apo nuk rezulton të ketë deklaruar ndryshime në pasuri apo detyrime të tjera.

26.10. Lidhur me blerjen e kësaj pasurie, trupi gjykues konstaton se, në deklarin periodik të vitit 2008 dhe deklarimin pas largimit nga funksioni, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar gjendje monetare *cash* apo llogari bankare të pakësuar, për të mundësuar pagimin e shumës për blerjen e kësaj pasurie, duke

²² Në nenin 676 të Kodit Civil parashikohet shprehimisht: “Kontrata quhet e lidhur kur palët kanë shfaqur në mënyrë të ndërsjellë vullnetin e tyre, duke u marrë vesh për të gjitha kushtet thelbësore të saj. Pra, palët kur lidhin kontratën duhet të merren vesh për kushtet që duhet të përmbahen në kontratë”.

mos provuar në këtë mënyrë, ai dhe personi i lidhur, znj. E. Sh, burimin e ligjshëm të krijimit të vlerës 45.000.000 lekë, për blerjen e truallit me sip. 1.058 m,² në bulevardin “{***}”, Tiranë.

26.11. Trupi gjykues vëren se subjekti i rivlerësimit ishte në dijeni të rëndësishë së procesit të rivlerësimit dhe të detyrimit ligjor që ai kishte, të deklaronte me saktësi dhe vërtetësi në deklaratën e pasurisë *vetting*, të ardhurat të përfituara nga shitja e kësaj pasurie të paluajtshme, sipas udhëzimit të ILDKPKI-së, datë 10.10.2016, “*Për mënyrën e deklarimit të pasurive, në pronësi, posedim dhe përdorim, burimet e krijimit të tyre, detyrimet financiare etj.*”. Këto të ardhura, subjekti i rivlerësimit duhej t’i deklaronte si të përfituara mbështetur vetëm në aktet ligjore që dokumentojnë se ai dhe bashkëshortja janë përfitues të kësaj prone, edhe pse subjekti pretendon se nuk ka përfituar nga ato veprime juridike që ka kryer bashkëshortja e tij. Ai duhej të provonte me prova të tjera të mundshme, direkte apo indirekte, se nuk ishte përfitues i tyre, qoftë me dorëzimin e deklaratës *vetting*, ashtu dhe gjatë procesit të rivlerësimit në Komision. Deklarata e thjeshtë (jo e mbajtur para noterit), datë 15.07.2023, e shtetasit A. T. konsiderohet me fuqi të kufizuar provuese në këtë proces, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit.

26.12. Trupi gjykues e analizoi këtë mosdeklarim të subjektit edhe në lidhje me rrethanat faktike të cilat iu nënshtruan analizës ligjore, si: nënshkrimi i kontratave të shitblerjes të truallit nga bashkëshortja e subjektit, si dhe nga vetë subjekti i rivlerësimit, në kontratën e vitit 2010, pa një akt përfaqësimi apo prokurë, për shuma të konsiderueshme financiare (45.094.790 lekë), transaksioni i të cilave nuk u provua me dokumentacion justifikues ligjor (mungesën e gjurmëve dokumentare, lëvizje bankare, mandatpagesa etj.). Gjithashtu konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka dhënë shpjegime as në deklaratën e pasurisë *vetting* dhe as në pyetësin standard, lidhur me veprimet juridike të kryera për blerjen dhe shitjen e kësaj pasurie, duke treguar indiferencë në pasqyrimin e së vërtetës. Veprimet e subjektit të rivlerësimit, ku edhe pse ka firmosur vetë në kontratën e shitblerjes së pasurisë, duke pretenduar se ishte në padijeni të ekzistencës së kësaj kontrate, vlerësohen nga trupi gjykues si përpjekje e tij në funksion të paraqitjes së të dhënave jo të vërteta, që lidhen me justifikimin e burimeve të ligjshme të kësaj pasurie.

26.13. Në përfundim, për pasurinë “truall me sipërfaqe 1.058 m²”, të ndodhur në bulevardin “{***}”, Tiranë, blerë nga bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit me çmim 45.094.790 lekë, në datën 07.10.2009, sipas kontratës noteriale, dhe shitur në datën 21.08.2010 me të njëjtin çmim, trupi gjykues vlerëson se u gjet i drejtë konkluzioni i Komisionit, se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk kanë deklaruar në deklaratën *vetting* të ardhurat nga shitja e këtij trualli, me qëllim për të mos ekspozuar të vërtetën dhe deformuar atë, lidhur me mungesën e burimeve financiare të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronja “c” e ligjit nr. 84/2016.

27. Në lidhje me depozitën në Intesa Sanpaolo Bank, në shumën 3.465.600 lekë

27.1. Komisioni arriti në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar depozitën në Intesa Sanpaolo Bank, në shumën 3.465.600 lekë, sipas parashikimeve të germave “a” dhe “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016.

27.2. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit si të pabazuar në prova dhe në ligj, pasi sipas tij, për depozitën në Intesa Sanpaolo Bank, në shumën 3.465.600 lekë, një pjesë e kësaj shume dhe konkretisht shuma prej 3.000.000 lekësh, është dhuruar nga vëllai i bashkëshortes, A. T., biznesmen, administrator i shoqërisë “{***}” ShPK, me nr. identifikimi NIPT {***}. Sipas subjektit, kjo shumë është kaluar nga llogaria e kunatit të tij në llogarinë e bashkëshortes, në Emporiki Bank, për t’u përdorur si garanci për në Ambasadë, për të nxjerrë një vizë greke për kurimin e djalit të tyre në Greqi, e më pas, vëllai i bashkëshortes nuk ka kërkuar kthimin e shumës në fjalë, pra ia ka dhuruar këtë shumë. Në lidhje me mundësinë financiare të kunatit, subjekti pretendon se ai e ka pasur dhe e ka aftësinë financiare për dhënie likuiditetesh, pasi ka biznese në Tiranë dhe në rrethe të tjera, ka qenë një nga aksionarët në kompaninë e naftës që operonte në zonën Vlorë – Fier, me emrin “{***}”.

27.3. Trupi gjykues konstaton se, lidhur me depozitën në Intesa Sanpaolo Bank, subjekti i rivlerësimit, në deklaratën e pasurisë *vetting*, ka deklaruar:

*“Depozitë në Intesa Sanpaolo Bank, në shumën 3.465.600 lekë, ku një pjesë e kësaj shume dhe konkretisht 3.000.000 lekë, është dhuruar nga vëllai im, A. T., biznesmen, administrator i shoqërisë “{***}” ShPK (PPA) me nr. identifikimi NIPT {***}. Kjo shumë është dhënë fillimisht për ta derdhur në NBG, si garanci për në Ambasadë, për të nxjerrë një vizë greke, për kurimin e djalit në Greqi, e më pas, nuk ma ka kërkuar shumën në fjalë, pra ma ka dhuruar këtë shumë. Dokumenti justifikues – statementi i nxjerrë nga Emporiki Bank Albania, ku vëllai im, A. T., më ka kaluar nga llogaria e tij në llogarinë time shumën në fjalë. Më pas, kësaj shume i është shtuar edhe një shumë prej 9.780 euro dhe 1.220.000 lekë, të dhënë nga mamaja ime dhe babai, dhe bashkë me 3.000.000 lekët e dhuruara nga vëllai, janë futur nga ana ime në NBG, me qëllim interesin e lartë që kishte kjo bankë. Më pas, në vitin 2015, gjithë shuma prej 5.631.186 lekësh është tërhequr për shkak të krizës greke dhe frikës së falimentit të Bankës Greke. Më pas, nga kjo shumë, 5.000.000 lekë i janë dhënë prindërve të mi për t’i përdorur për probleme shëndetësore/operacione dhe shuma prej 635.000 lekësh është mbajtur për pagesa për shkollën e djalit. Në maj të vitit 2016, prindërit e mi më kanë kthyer shumën prej 3.500.000 lekësh dhe 8.500 USD, të cilat janë depozituar në Intesa Sanpaolo Bank. Dokumenti justifikues – statementi i lëshuar nga banka dhe vërtetimi i lëshuar nga shoqëria “{***}”. Shuma 3.465.000 lekë, pjesa 100%”. Subjekti i ka bashkëlidhur deklaratës *vetting* dokumentacionin²³ justifikues për këtë depozitë.*

27.4. Trupi gjykues vëren se, në datën 13.05.2016, në llogarinë bankare në Intesa Sanpaolo Bank²⁴, në emër të bashkëshortes së subjektit, E. Sh, është depozituar *cash* vlera 3.500.000 lekë, me përshkrimin “Kursime tërhequr nga Banka NBG viti 2015”. Sipas deklarimeve të sipërcituara të subjektit të rivlerësimit, kjo depozitë e ka origjinën e saj nga dhurimi i vlerës prej 3.000.000 lekësh, nga vëllai

²³ (i) Pozicioni i klientit, E. Sh., në ISP Bank, për gjendjen në llogari rrjedhëse në shumën 3.465.600 lekë, në datën 24.01.2017; (ii) nxjerrje llogarie e E. Sh. në Emporiki Bank, për periudhën 01.01.2006 – 01.01.2007, në të cilën evidentohet kreditimi i shumës 3.000.000 lekë, nga A. T., në datën 15.06.2006; (iii) nxjerrje llogarie e E. Sh. në NBG Bank, e datës 17.03.2016, sipas së cilës, në datën 26.04.2015, transferohet në llogari shuma 5.651.635 lekë, e përfituar nga këmbimi me euro, shumë me të cilën, në datën 04.05.2015, çelet depozitë dhe në datën 08.07.2015, kjo shumë tërhiqet *cash* nga banka; (iv) nxjerrje llogarie E. Sh., në ISP Bank, periudha 01.01.2016 – 24.01.2017, me gjendje 3.465.600 lekë. Në datën 13.05.2016 evidentohet depozitimi *cash* i shumës 3.500.000 lekë, me përshkrimin “kursime, tërhequr nga NBG, viti 2015”.

²⁴ Referuar lëvizjeve të llogarisë bankare që ISP Bank i ka dërguar Komisionit me shkresën nr. {***} prot., datë 16.02.2021.

bashkëshortes së subjektit, A. T., në ish-Emporiki Bank, në vitin 2006, e cila, pasi është tërhequr në vitin 2009, dhe së bashku me shumat e dhëna nga prindërit e bashkëshortes në vitin 2011, janë depozituar në NBG Bank. Në vitin 2015, pasi është tërhequr vlera 5.000.000 lekë, i është dhënë prindërve të bashkëshortes për probleme shëndetësore, të cilët pasi i kthyen vlerën prej 3.500.000 lekësh dhe 8500 USD, në muajin maj 2016, i depozituan në Intesa Sanpaolo Bank.

27.5. Në funksion të shqyrtimit të pretendimeve të subjektit të rivlerësimit në ankim dhe të konkluzionit të Komisionit, trupi gjykues vlerësoi të analizojë historikun e krijimit të likuiditetit, ecurinë dhe mënyrën e kalimit dhe transferimit të këtyre shumave në ish-Emporiki Bank dhe ish-NBG Bank, për t'i ballafaquar dhe kontrolluar më pas ato, në raport me deklaratimet ndër vite të subjektit në ILDKPKI, si dhe gjatë hetimit administrativ në Komision.

27.5/a. Lidhur me likuiditetin në Emporiki Bank²⁵ (sot ABI Bank) rezulton se, në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit, E. Sh, në datën 15.06.2009, është kredituar një kalim nga A. T. në vlerën 3.000.000 lekë. Kjo vlerë është mbajtur gjendje në llogari dhe më pas është investuar në depozitë së bashku me interesat e përfituara. Më datë 25.06.2009 është tërhequr shuma prej 1.500.000 lekësh, me përshkrimin “*tërheqje nga E. Sh, mobilim shtëpie*” dhe një tjetër tërheqje është bërë në datën 02.07.2009, në shumën prej 1.500.000 lekësh, me përshkrimin “*tërheqje nga E. Sh, mobilim shtëpie*”²⁶.

Trupi gjykues konstaton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur nuk e kanë deklaruar këtë likuiditet të tërhequr nga banka si gjendje *cash* në banesë, në deklaratën pas largimit nga funksioni, (datë largimi nga detyra 02.09.2009 dhe data e dorëzimit të deklaratës 25.05.2010), i cili, sikurse pretendohet prej subjektit, është përdorur si likuiditet për hapjen e llogarisë bankare në ish-NBG Bank, në qershor 2011.

27.5/b. Lidhur me likuiditetin në ish-NBG Bank (sot ABI Bank), shumën prej 3.800.000 lekësh, konstatohet se, në datën 24.06.2011, në llogarinë²⁷ e hapur nga bashkëshortja e subjektit, E. Sh, është kryer depozitim *cash* në shumën prej 1.000.000 lekësh, në datën 08.08.2011, shuma prej 2.000.000 lekësh, ndërsa në datën 13.04.2012, shuma prej 800.000 lekësh. Këto vlera dhe me vlerat e tjera²⁸ (veçmas ose së bashku) janë investuar në depozita me afat, përfshirë interesat, duke i konvertuar disa herë nga lekë në euro dhe anasjelltas nga euro në USD, derisa në datën 28.04.2015, vlera prej 40.340,01 eurosh u konvertua dhe ekuivalenti prej 5.651.635,4 lekësh është kaluar në llogarinë në lekë, duke u investuar në depozitë. Më datë 08.07.2015, e gjithë shuma prej 5.651.635 lekësh është tërhequr *cash* nga bashkëshortja e subjektit.

27.5/c. Nga aktet e dosjes së Komisionit rezulton se, në pyetësorin nr. 2, subjekti i rivlerësimit, i pyetur në lidhje me mosdeklarimin e shumës prej rreth 5.1 milionë lekësh, të disponuar nga bashkëshortja në

²⁵ Referuar lëvizjeve të llogarisë bankare që ABI Bank (ish-NBG Bank) i ka dërguar Komisionit nr. {***} prot., datë 02.02.2021.

²⁶ Sipas shpjegimeve të subjektit në Komision, përshkrimi ishte arsye e dhënë në bankë që të mund të tërhiqeshin fondet, pasi në të kundërt banka nuk i jepte lekët.

²⁷ E. Sh. ka hapur llogari në lekë nr. {***}, në USD nr. {***} dhe në euro nr. {***}, midis të cilave ka kryer kalime të vlerave të depozitave, duke i konvertuar e investuar në monedha të ndryshme.

²⁸ Sipas akteve, lëvizjeve të llogarive rezulton se janë kryer transfertat si vijon: transfertë nga e njëjta bankë nga F. T., mamaja e E. Sh., në 17.10.2012 është kaluar shuma prej 1.054.448,7 lekësh; transfertë nga e njëjta bankë nga S. T., babai i E. Sh., në 17.10.2012 është kaluar shuma prej 70.890 lekë; transfertë nga e njëjta bankë, nga E. Sh., djali i E. Sh., në 17.10.2012, me vlerë prej 70.890 lekë.

llogarinë në NBG, para fillimit të detyrës, si dhe në lidhje me burimin e të ardhurave për krijimin e kësaj shume, ka deklaruar se ka harruar ta deklarojë atë.²⁹ Sipas shpjegimeve të subjektit, vlera prej 5.000.000 lekësh i është dhënë prindërve të bashkëshortes së tij për problemet e tyre shëndetësore dhe, në muajin maj 2016, prindërit e bashkëshortes e kthyen shumën prej 3.500.000 lekësh dhe 8500 USD, të cilat bashkëshortja e tij i depozitoi në Intesa Sanpaolo Bank. Sa i përket deklaratës noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 22.06.2016, të prindërve të bashkëshortes së subjektit, të cilët konfirmojnë se e kanë ndihmuar në vazhdimësi vajzën e tyre dhe familjen e saj, konstatohet se, përveç likuiditeteve të dhëna prej tyre deri në vitin 2008, ata në këtë deklaratë nuk shprehen në mënyrë eksplicite për kalimet në ish-NBG Bank, në vitin 2012.

27.5/ç. Trupi gjykues konstaton se likuiditeti në ish-NBG Bank nuk është deklaruar prej subjektit në deklaratën para fillimit të detyrës (data e emërimit në detyrë 09.01.2013 dhe dorëzimi i deklaratës në datën 08.02.2013), por ai nuk e ka deklaruar as në vijim në DIPP-në 2013 dhe në DIPP-në 2014 (këtu janë deklaruar vetëm interesat nga llogaria në NBG Bank), duke mos deklaruar në këtë mënyrë edhe burimin e krijimit të këtij likuiditeti. Vetëm në një periudhë të mëvonshme, në DIPP-në 2015, bashkëshortja e subjektit ka deklaruar tërheqjen nga kjo depozitë të shumës prej 5.651.635 lekë, si dhe faktin që ia ka dhënë nënës së saj për t'i përdorur për probleme shëndetësore, ndërsa në DIPP-në 2016, ajo ka deklaruar krijimin e depozitës objekt analize në Intesa Sanpaolo Bank.

27.6. Lidhur me dhurimin e vlerës prej 3.000.000 lekësh nga A. T. (vëllai i bashkëshortes së subjektit), në Emporiki Bank, trupi gjykues konstaton se subjekti dhe personi i lidhur e kanë deklaruar³⁰ atë në DIPP-në 2006, por nuk e kanë deklaruar si likuiditet në vitet në vijim. Sa i përket deklaratës noteriale nr. {***} rep., {***} kol., datë 10.06.2016, të shtetasit A. T., i cili ka konfirmuar se i ka dhënë motrës tij vlerën prej 3.000.000 lekësh, si garanci bankare për nxjerrjen e vizës për në Greqi, trupi gjykues konstaton se, edhe nga aktet e fashikullit, nuk rezulton që subjekti të ketë paraqitur ndonjë dokument (kopje pasaporte, aplikim vize), për të provuar se është pajisur me vizë greke në periudhën kur i janë transferuar vlerat monetare në llogari bankare nga kunati, A. T. Gjithashtu, kjo deklaratë është hartuar disa ditë para se subjekti të jepte shpjegime³¹ në ILDKPKI (23.06.2016) lidhur me këtë dhurim, çka

²⁹ “Shuma prej 5.100.000 lekësh është harruar të deklarohet në DIPP-në para fillimit të detyrës, por theksoj se në vitin 2014 është deklaruar interesi nga kjo depozitë dhe është deklaruar edhe në DPV-në e vitit 2015, ku është bërë tërheqja e kësaj shume nga NBG. Sa i përket ecurisë së kësaj shume, deri më 08.07.2015, në NBG dhe pas tërheqjes nga kjo bankë, për shkak të frikës së krizës greke, janë depozituar në Intesa Sanpaolo Bank, në datën 13.06.2016 dhe që atëherë nuk janë lëvizur nga kjo bankë. Burimi i shumës prej 5.100.000 lekësh përbëhet nga shuma e dhuruar nga vëllai i bashkëshortes në Emporiki Bank dhe kursimet e prindërve të bashkëshortes”.

³⁰ Në DIPP-në 2006, subjekti dhe personi i lidhur kanë deklaruar se: “3.000.000 lekë nga kunati A. T., biznesmen, administrator i shoqërisë “{***}” ShPK (PPA) me nr. identifikimi NIPT {***}, për ta derdhur në NBG si garanci për në Ambasadë, për të nxjerrë një vizë greke për kurimin e djalit në Greqi”. Në po të njëjtën DIPP, subjekti deklaron: “2.400 dollarë + 4.000 euro + 200.000 lekë, dhuruar nga e ëma e bashkëshortes sime, në Tirana Bank”.

³¹ Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 23 qershor 2016, subjekti, i pyetur në lidhje me mundësinë financiare të kunatit, ka deklaruar: “Kunati e ka pasur dhe e ka aftësinë financiare për dhënie likuiditetesh, pasi këtë gjë ka bërë qysh kur jam martuar me motrën e tij. Që në kohën e fejesës, kunati ka bërë vazhdimisht pagesa ose më saktë i ka dhënë gruas time për shpenzime familjare, për lëvizje jashtë shtetit, për probleme shëndetësore të djalit tim dhe nipit të tij. Për sa i përket aftësisë financiare, dua të sqaroj se ai ka biznese në Tiranë dhe në rrethe të tjera të vendit. Sa i takon shumës, është tërhequr nga bashkëshortja dhe likuiditeti është mbajtur në shtëpinë e vjehrrës. Ndërsa në lidhje me shumën e dhuruara nga nëna, subjekti ka deklaruar se: “Në vitet 2006 – 2007, nëna i ka dhuruar bashkëshortes likuiditetet e mësipërme për t'i depozituar në bankë dhe për t'i përdorur për nevojat e saj dhe të prindërve. Në 2006 – 2007, gjendja shëndetësore e vjehrrës është përqësuar dhe për këtë shkak ajo ka bërë ndërhyrje kirurgjikale të rëndë në Ankara të Turqisë. Në atë kohë i ka dhënë

duket se është hartuar në mbështetje të deklarimeve të subjektit. Për rrjedhojë, pretendimi i tij mbetet i pambështetur me dokumentacion justifikues ligjor.

27.7. Lidhur me pretendimin e subjektit, se kunati i tij, A. T., ka pasur mundësi financiare për të dhuruar shumën prej 3.000.000 lekësh, trupi gjykues konstaton se Komisioni në vendim nuk shprehet lidhur me mundësinë financiare të kunatit të subjektit për këtë kalim/dhurim.

Megjithatë, nga dokumentacioni që subjekti i rivlerësimit ka depozituar në Komision, konstatohet se ai përmban të dhëna mbi veprimtarinë e A. T. në fushën e biznesit, por jo të ardhurat e tij apo fitimin nga biznesi. Për aktet e sjella nga subjekti, që lidhen me të ardhurat e A. T., ato janë trajtuar më sipër në shkakun e ankimit lidhur me automjetin.

27.8. Nga sa më sipër, trupi gjykues konstaton se shuma prej 3.000.000 lekësh, e pretenduar e dhuruar nga vëllai i bashkëshortes, në vitin 2006, tërhequr nga bashkëshortja në vitin 2009, nuk është deklaruar si gjendje *cash* në banesë, as në deklaratën pas largimit nga detyra, në vitin 2009 dhe as në deklaratën para marrjes së detyrës, në vitin 2013. Burimi i këtij likuiditeti është deklaruar për herë të parë në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, më datë 23.06.2016, në deklaratën *vetting* e në DIPP-në 2016, gjatë procesit në Komision, por nuk gjen pasqyrim në deklaratat periodike ndër vite, që nga momenti i deklaramit të parë në DIPP-në 2006, e si ka vijuar kjo pasuri më pas.

27.8/a. Trupi gjykues, bazuar në rrethanat faktike të prezantuara, konkretisht referuar përshkrimit të tërheqjeve të shumave të ndryshme nga banka (lëvizjeve të tyre), shuma të cilat janë depozituar kohë më pas në bankë, vëren se nuk ekziston një lidhje koherente midis shumës së transferuar në vitin 2006, prej vëllait të bashkëshortes, në llogarinë bankare të bashkëshortes së subjektit dhe tërhequr prej saj për qëllimin e pretenduar. Kjo shumë nuk rezulton që të jetë ridepozituar sërish prej saj, madje në vitin 2009 e gjithë shuma u tërhoq me dy veprime bankare, me përshkrim që prezumonte shpenzimin e saj (mobilitim shtëpie).

27.8/b. Lidhur me deklaramin si gjendje likuiditeti në vitin 2016, të po kësaj shume, prej 3.000.000 lekësh, trupi gjykues vëren se provohet mungesa e lidhjes midis shumave të pretenduara nga subjekti i rivlerësimit, duke u përforcuar më tej edhe me mosdeklaramin e tyre në deklaratat e interesave privatë periodikë vjetorë, si edhe me faktin që në vitin 2011 subjekti ka blerë pasurinë “apartament me sip. 138 m²”, në godinën e ndërtuar në rrugën “{***}”. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se likuiditeti prej 3 milionë lekësh, kaluar nga kunati i subjektit, në vitin 2006, me transfertë bankare, dhe që shërbeu si garanci financiare për marrjen e vizës për djalë të tij, nuk mund të kenë shërbyer si burim i krijimit të depozitës në Intesa Sanpaolo Bank shumë vite më vonë dhe të deklaruar në deklaratën e pasurisë *vetting*.

27.9. Trupi gjykues vlerëson se pretendimi i subjektit, mbi pasaktësitë në mënyrën e deklaramit të likuiditeteve, nuk qëndron dhe është i pakuptimtë, pasi nuk përputhet me formimin e subjektit si jurist/magjistrat prej shumë vitesh dhe as me faktin që ka qenë subjekt deklarues që në vitin 2003. Këto pretendime bien ndesh me gjuhën e qartë të përdorur nga legjislatori në ligjin nr. 9049/2003, “Për

bashkëshortes këtë likuiditet për ta pasur. Në deklaratën noteriale, të lëshuar nga prindërit, është përmendur si fakt ndihma që prindërit kanë dhënë dhe japin në vazhdimësi, në mbështetje të këtij fakti, subjekti ka paraqitur dy kontrata qiraje”.

deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar,³² dhe formulari i deklarimit të interesave privatë. Këto dy dokumente përcaktojnë detyrimin e zyrtarit deklarues për të deklaruar gjendjen e parave dhe burimin e tyre, pa lënë vend për mundësi nënkuptimi, dhe nuk justifikojnë neglizhencën e subjektit të rivlerësimit në mënyrën e plotësimit të deklaratave periodike vjetore.

27.10. Bazuar në këto konkluzione, rezulton se shpjegimet e subjektit të rivlerësimit në lidhje me ekzistencën e likuiditeteve janë në kundërshtim me deklaratimet e bëra prej tij në deklaratat periodike të interesave privatë. Këto deklarata përbëjnë provën kryesore shkresore në procesin e rivlerësimit, sipas përcaktimeve të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, të cilat, të interpretuara në mënyrë të integruar me deklaratën e pasurisë *vetting*, përbëjnë një ndër burimet e verifikimit të ekzistencës së pasurisë në formën e likuiditeteve. Në këto kushte, pretendimet e subjektit nuk arritën të përmbysin gjetjet e Komisionit në përfundim të rezultateve të hetimit, e për pasojë, ato mbeten në nivel deklarativ dhe nuk përmbushin standardin e besueshmërisë së kërkuar për procesin e rivlerësimit të pasurisë.

27.11. Në përfundim, për depozitën në Intesa Sanpaolo Bank, në shumën 3.465.600 lekë, trupi gjykues, ashtu si edhe Komisioni, vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka bërë deklarim të pasaktë dhe ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar krijimin e kësaj depozite, duke u ndodhur në kushtet e nenit 33, pika 5, shkronjat “a” dhe “b”, të ligjit nr. 84/2016.

28. Lidhur me konkluzionin e Komisionit, se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te drejtësia, trupi gjykues, megjithëse e konsideron të drejtë konstatimin e Komisionit, në raport me sjelljen e subjektit dhe mungesën e tij në seancën dëgjimore dhe në seancën e shpalljes së vendimit, duke paraqitur raport mjekësor, jo sipas formës së kërkuar nga ligji, pikërisht në ditën kur ishte caktuar seanca dëgjimore, si përpjekje të subjektit për të shtyrë seancën dëgjimore dhe, si rrjedhojë, për shtyrjen dhe vonesën e procesit e tij të rivlerësimit, vlerëson se veprimet dhe mosveprimet e subjektit të rivlerësimit për të ndikuar në pengimin e punës së organeve të rivlerësimit, si një rrethanë e vetme në procesin e tij të rivlerësimit, nuk mund të marrin peshë dhe të ngrihen në atë nivel për të konkluduar se ai ka cenuar besimin e publikut, sipas parashikimeve të nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 dhe, për rrjedhojë, nuk e përfshiu atë në konkluzionin përfundimtar.
29. Në përfundim, trupi gjykues, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklarim të pamjaftueshëm dhe, për rrjedhojë, nuk është i besueshëm për kriterin e vlerësimit të pasurisë, në kuptim të nenit D, pikat 1, 3 dhe 5, të Aneksit të Kushtetutës, dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, duke u gjendur në këtë mënyrë në një prej rasteve të parashikuara nga ligji për vendosjen e masës disiplinore “shkarkim nga detyra”. Për sa më lart, vendimi nr. 694, datë 10.08.2023, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

³² Sipas nenit 4, të ligjit nr. 9049/2003, subjektet deklaruese kanë pasur detyrimin të deklarojnë çdo shtesë të pasurisë së luajtshme dhe të paluajtshme, duke e përshkruar atë hollësisht dhe burimin e krijimit të saj dhe situatës faktike konkrete.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 694, datë 10.08.2023, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Bardhyl Shehu.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, më datë 19.11.2025, në Tiranë.

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

RELATORE

Mimoza TASI

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi